SHËRBIMI PËRMBARIMOR

# Raporti Vjetor

## për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura të

# SHPGJSH

# 2025

## Hyrje

Në funksion të rritjes së efikasitetit të zyrave përmbarimore vendore dhe uljes së numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura ndër vite, me Urdhër nr. 810 Prot., nr. 62, datë 12.06.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm Përmbarimit është miratuar Plani i Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.

Masat e parashikuara në këtë plan rrjedhin nga objektivat dhe prioritetet e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, si dhe nevojave institucionale për të adresuar situatën problematike të krijuar nga mbartja ndër vite e një numri shumë të lartë dosjesh përmbarimore, të cilat kanë ngelur pa ekzekutuar apo pa u dhënë zgjidhje ligjore, për shkak të: mungesës së pasurisë së palës debitore; pamundësia në ekzekutimin e objektit të çështjes përmbarimore; mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional; mos gjetjes së adresave të sakta të palëve debitore; ndryshimet ligjore si ligji për amnistinë etj.

Ky plan synon uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura, përmirësimin e efikasitetit të veprimtarisë përmbarimore, me qëllim përforcimin e besimit tek shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe rritjen e performancës të këtij shërbimi, duke garantuar një proces të rregullt ligjor.

Raporti vjetor mbi zbatimin e Planit të Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura pasqyron ecurinë e veprimeve të ndërmarra nga zyrat përmbarimore gjatë vitit 2025 për përmirësimin e efikasitetit të shërbimit dhe rritjen e efektivitetit të procedurave përmbarimore.

Raporti përmban informacion mbi progresin e zbatimit të masave të parashikuara, duke përfshirë trajtimin e dosjeve me objekt detyrime në të hollë, lirim dhe dorëzim sendi, shpenzime gjyqësore, gjoba administrative, si dhe monitorimin dhe raportimin periodik të veprimeve përmbarimore. Përmes këtij raporti synohet të evidentohen rezultatet e arritura, sfidat e hasura dhe masat e nevojshme për të përmirësuar më tej performancën e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Ky raportim mbi realizimin e masave të parashikuara në Planin e Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura bazohet në vlerësimn e bërë nga vetë Zyrat Përmbarimore Vendore.

**Miratoi: Drejtor i Përgjithshëm  i Përmbarimit– ERGYS QIRICI**

**Punoi Drejtor i Inspektimit – ENTELA TOÇI**

## OBJEKTIVI 1: ULJA E NUMRIT TË DOSJEVE PËRMBARIMORE TË MBARTURA

| | | |
|---|---|---|
| **Masa Nr.1.1**<br>**Identifikimi dhe trajtimi i dosjeve përmbarimore më prioritare për t'i dhënë zgjidhje ligjore.** | | |
| **Përshkrimi i problemit:** | Numër i lartë i dosjeve të përmbarimore të mbartura nga viti në vit, kryesisht me objekt "gjoba penale" dhe "shpenzime gjyqësore". | |
| **Masa: 1.1.1 Klasifikimi i dosjeve të mbartura sipas llojit (gjoba penale, shteti debitor, shteti kreditor, kthim shume, takim fëmije, çështje që lidhen me pronësinë etj.)** | | |
| **Masa: 1.1.2 Evidentimi i dosjeve përmbarimore të mbartura më prioritare për t'u dhënë zgjidhje ligjore.** | | |
| **Kompetenca:** | **Institucion përgjegjës** | **Institucion kontribues** |
| | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | DPP |
| **Burimet:** | Kryetarët dhe Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë | |
| **Koha:** | Kohëzgjatja: 1 vit nga koha e miratimit | Faza : |

### Masa 1.1 Identifikimi dhe trajtimi i dosjeve përmbarimore më prioritare për t'i dhënë zgjidhje ligjore

**Progresi:**

Në vijim të zbatimit të Planit të Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura, gjatë vitit 2025 është realizuar evidentimi i plotë i dosjeve përmbarimore më prioritare, me fokus të veçantë në kategoritë me volum më të lartë dhe ndikim të drejtpërdrejtë.
Prioritet në trajtim i është dhënë:

- Dosjeve me objekt gjoba penale, përfituese nga Ligji nr. 33/2024 "Për Amnistinë";
- Dosjeve me objekt gjoba administrative, përfituese nga Ligji nr. 127/2024 "Për shfuqizimin e masave administrative" dhe VKM nr. 274, datë 09.05.2025;
- Dosjeve me shtetin kreditor (shpenzime proceduriale-gjyqësore, gjoba penale dhe administrative);

- Dosjeve me objekt kthim shume dhe çështjeve kontraktuale private;
- Dosjeve që lidhen me pronësinë.

Nga zyrat përmbarimore vendore është bërë evidentimi i plotë i dosjeve për të cilat janë kryer procedura përmbarimore, si dhe është përcaktuar prioriteti në ekzekutim, duke përzgjedhur ndër të tjera për trajtim dosjet për të cilat palët kreditore nuk kanë shfaqur interes prej një përiudhe të gjatë.

Për çështjet me objekt kthim shume kontraktuale, dosjet janë në fazë ekzekutimi dhe po vijon me likuidimin e pjesshëm të detyrimit. Ndërsa për çështjet me objekt shpenzime gjyqësore të palikuiduara, janë ndërmarrë veprime për njoftimin përmes forcave të Policisë.

Nga përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë është vijuar me ripërsëritjen e urdhrave të sekuestros për dosjet prioritare, si dhe me komunikimin periodik me institucionet kreditore për verifikimin e përfitimit nga ligjet e amnistisë apo shfuqizimit të masave administrative. Në disa raste janë administruar përgjigje zyrtare nga prokuroritë përkatëse lidhur me statusin e përfituesve.

Në kuadër të uljes së numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura, është konsideruar se dosjet më prioritare janë ato me kohëzgjatjen më të madhe në ekzekutim, me qëllim ekzekutimin tërësisht ose dhënien e zgjidhjes ligjore sipas rastit.

Masa për evidentimin dhe përcaktimin e prioriteteve në ekzekutim rezulton e realizuar 100% që prej muajit korrik 2025, ndërsa vijon ndjekja dhe trajtimi i dosjeve sipas kategorive përkatëse.

**Problematikat:**

- Ngarkesa e lartë e punës për shkak të numrit të madh të dosjeve përmbarimore të regjistruara në total.

**Hapat në vijim**

- Do të vijohet me klasifikimin dhe identifikimin e të gjitha dosjeve përmbarimore të mbartura sipas objektit.
- Do të pasqyrohen të dosjet përmbarimore të mbartura të evidentuara edhe në statistikat zyrtare të zyrave vendore përmbarimore.

**Statusi**

Shumica e zyrave raportojnë se janë në proces, me disa aktivitete të realizuara plotësisht dhe disa të tjera pjesërisht. Procesi i klasifikimit të dosjeve të mbartura ka përparuar ndjeshëm në shumicën e zyrave vendore, duke shënuar përmirësime në evidentimin dhe kategorizimin e tyre.

**Masa: 1.1.1 Klasifikimi i dosjeve të mbartura sipas llojit (gjoba penale, shteti debitor, shteti kreditor, kthim shume, takim fëmije, çështje që lidhen me pronësinë etj.)**

| 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | Progresi i masës / aktivitetit për DHJETOR (Përshkruaj me fjalë të gjithë veprimtarinë e ndjekur për realizimin e masës) | Problematikat (elemente që kanë penguar realizimin e aktivitetit) | Hapat që do vijojnë (përshkruaj aktivitetet që do ndiqen në të ardhmen për realizimin e aktivitetit) | Vendosni statusin e masës (I parealizuar/në proces/ I realizuar) |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| ZP Durrës | Gjatë muajit Dhjetor përmbaruesit kanë qënë dhe me lejen vjetore, kanë vijuar me procesin e klasifikimit të dosjeve, ku prioritet i është dhënë evidentimi i dosjeve me gjoba penale përfitues aminstis dhe ligji për shfuqëzimin e gjobave administrative | Mos pasja e një informacionin më të shpejtë nga institucionet për ti dhënë një zgjidhje ligjore dosjeve me këto objekte. | Janë evidentuar të gjitha dosjet dhe dhenia e një zgjidhjeje ligjore | Realizuar |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | Janë klasifikuar dosjet përmbarimore me kreditor AMGKP, çështjet që lidhen me pronësinë, shteti kreditor dhe gjobat penale | Problematika kryesore është moskthimi i përgjigjeve nga ana e ASHK dhe mosvënia e sekuestros nga DPSHTRR. | Përsëritje e urdhrave të sekuestros konservative dhe kërkesë për mbështetje institucioneve | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | Janë klasifikuar dosjet sipas ligjit . Kemi vijuar edhe me verifkimin e çështjeve me obejkt takim fëmije dhe pension ushqimor, kur ato kanë mbushur moshën madhore dhe sipas rastit nuk vazhdojnë arsimin e lartë dhe për këto veprime kemi vënë në dijeni palën kreditore. | Mungesa e pasurive të palëve debitore dhe mungesa e informacionit të plotë nga DRSHTRR dhe DRASHK Shkodër për çështjet me objekt të vleftësueshëm që bëhet pengesë për hetimin shterues pasuror. | Do të evidentohen të gjitha çështjet sipas rubrikave në mënyrë që brenda afatit përkatëse ti jepet zgjidhje ligjore dhe të ulet numri i dosjeve të mbartura . | realizuar |
| ZP Elbasan | Janë klasifikuar dosjet e mbartura sipas llojit ku në total rezultojnë se janë shteti kreditor, debitor 4 3114dosje të ndryshme (Prokurori dhe Policia Kufitare) shteti kreditor, 32 dosje kontraktuale, 13 dosje gjoba penale | Mos marrja e informacionit pranë ASHK nëse ka pasuri të paluajtëshme dhe mos vendosja e sekuestros konservative nga ASHK-ja dhe DRSHTR-ja për dosjet të cilat rezultojnë se kanë pasuri | 1. I jemi drejtuar me shkresë Policisë së Shtetit për vendodhjen e debitorëve dhe Gjendjes Civile si dhe Drejtorisë Burgjeve. | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë klasifikuar dosjet e mbartura sipas llojit ku në total rezultojnë se janë 16 dosje të mbartura me palë shteti kreditror(ATK), 259 dosje të ndryshme (Prokurori dhe Policia Kufitare), 30 dosje kontraktuale, 13 dosje gjoba penale | Mos marrja e informacionit pranë ASHK nëse ka pasuri të paluajtshme dhe mos vendosja e sekuestros konservative nga ASHK-ja dhe DRSHTR-ja për dosjet të cilat rezultojnë se kanë pasuri | 1. Janë njoftuar me shkresë palët kreditore nëse kanë interes në ekzekutimin e dosjeve<br>2. I jemi drejtuar me shkresë Policisë së Shtetit për lokalizimin e debitorëve që të paraqiten në Zyrën e Përmbarimit, | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Vlorë | Në zbatim të Planit te Punës të SHPGJSH për uljen e numrit të dosjeve të mbartura janë marr masat si më poshtë:<br>Është bërë klasifikimi dhe kategorizimi i dosjeve të mbartura sipas objektit, vjetërsisë, dhe problematikës së tyre. | Nuk kemi hasur asnjë problematikë për realizimin e kësaj mase | Dosjet përmbarimore të mbartura ndër vite janë pasqyrohen në tabela statistikore mujore dhe progresive nga secili përmbarues | realizuar |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100% prej muajit Gusht 2025. Dosjet përmbarimore, të cilat ekzekutohen apo ju jepet zgjidhje ligjore në fund të çdo muaji pasqyrohen në tabela statistikore mujore dhe progresive nga secili përmbarues, kjo për një monitorim sa me efektiv të përformances te sejcilit. | Nuk kemi hasur asnjë problematikë për realizimin e kësaj mase. | Do të vijoj pasqyrimi i dosjeve përmbarimore të ekzekutuara apo me zgjidhje ligjore në tabela statistikore mujore dhe progresive,fakt i cili e ben më të lehtë llogaridhënien përpara instuticionit mbikqyrës DPP. | I realizuar |
| ZP Fier | Është bërë ndarja e të gjitha dosjeve sipas objekteve të ndryshme. Dosjet e ndryshme me palë janë trajtuar të gjitha. Dosjet që kemi pasur mundësi janë pezulluar. | Mbingarkesa e punës.Viti 2025 ka pasur dhe shumë çështje të reja të regjistruara. | Fokusi i ndarë në dy drejtime. Njoftimi i kreditorëve për shprehje interesi. Presioni ligjor mbi debitorët për të shlyer detyrimet. | Realizuar pjesërisht.dhe në proces. |
| ZP Sarandë | Është bërë klasifiimi i të gjitha dosjeve të mbartura fillimisht sipas objekteve gjatë muajit Dhjetor. | Nuk kemi hasur problematika | | realizuar |
| ZP Gjirokastër | Është bërë klasifikimi i dosjeve të mbartura sipas llojit ( Gjoba penale dhe gjoba administrative), klasifikimi i lidhur kryesisht me evidentimin e dosjeve përmbarimore me Objekt: Gjoba Penale, përfitues të Ligjit të Amnistisë, si dhe evidentimi i dosjeve përmbarimore me Objekt : Gjoba Administrative, përfitues të Ligjit për Shfuqizimin e Gjobave Administrative | Mospasja e informacionit të kërkuar nga ana e institucioneve në kohë, për t'i dhënë zgjidhje ligjore sa më shpejt këtyre çështjeve përmbarimore | Procesi i vijimit të evidentimit të të gjitha çështjeve përmbarimore, për t'u dhënë zgjidhje ligjore | Në proces |
| ZP Tropojë | Klasifikim i plotë | Nuk kemi pasur Problematika . | | I realizuar 100% |
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | Dojset përmbarimore janë klasifikuar sipas objekteve përkatëse nga secili përmbarues gjyqësor, janë pasqyruar dhe në statistikat progresive të përmuajshme. Kemi vijuar me klasifikimin e dosjeve dhe sikundër pjesën e me të madhe e zënë çështjet me objekt shpenzime gjyqësore, çështjet me AMGKP e gjoba penale dhe kontraktuale private; kemi proceduar me ripërseritjen e urdhërave të sekuestros për këto kateori duke u përcjelle edhe kreditorit për dijeni . Gjithashtu kemi proceduar me dërgimin e kërkesave palëve | Ngarkesa e përmbaruesve gjyqësore për shkak te numri te lartë dosjeve që ka në ngarkim secili përmbarues gjyqësor si dhe problematikat me dërgimin e akteve përmabrimroe për shkak te adresave te mangeta apo problematikave që me gjetjen e adresave te debiore. | Do të procedohet për çdo fazë të mëtejshme procedurale hap pas hapi sipas dispozitave të K.Pr.C | I realizuar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | kreditore për interesim në dosjet të cilat kanë vite që nuk janë interesuar  për dosjet me objekt kthim shume .Kemi vijuar edhe me verifkimin e çështjeve me objekt takim femije dhe pension ushqimor kur ato kanë mbushur moshen madhore dhe sipas rastit nuk vazhdojne arsimin e larte.Për një pjesë te mire te tyre  kemi proceduar me administrimin e përgjigjeve zyrtare dhe me dhënien zgjidhje ligjore të tyre sipas rastit | | | |
| ZP Dibër | Veprimtaria e Kryetares së Zyrës Përmbarimore Dibër dhe e përmbarueses gjyqësore, ka qënë venia e urdhrave të sekuestros në bankat e nivelit të dytë, DRSHTRR dhe DRT | Problematika  e hasur lidhur me realizimin e aktivitetit është se shumica e debitorëve ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërië. | Përsoneli i Zyrës Përmbarimore po bën ç'është e mundur për tu lidhur me debitorët dhe familjarët e tyre. | Në proces. |
| ZP Shkodër | Është bërë klasifikimi i dosjeve të mbartura sipas llojit; klasifikimi i lidhur kryesisht me evidentimin e dosjeve përmbarimore me objekt: Gjoba Penale, përfitues të Ligjit të Amnistisë, është kryer nga ana e Zyrës Shkodër dhe evidentimi i dosjeve përmbarimore Gjoba Administrative, përfitues të Ligjit për Shfuqizimin e Gjobave Administrative është kryer gjithashtu dhe ka ardhur përgjigje nga IMT | Mospasja e informacionit të kërkuar nga ana e institucioneve në kohë, për t'i dhënë zgjidhje ligjore sa më shpejt këtyre çështjeve përmbarimore. | Procesi i vijimit të evidentimit të të gjitha çështjeve përmbarimore, për t'u dhënë zgjidhje ligjore | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Gjatë periudhës raportuese është vijuar me procesin e klasifikimit të dosjeve. Pjesën më të madhe të tyre e zënë çështjet me objekt shpenzime gjyqësore, si dhe ato që lidhen me AMGKP dhe gjobat penale. Për këto kategori është proceduar me ripërsëritjen e urdhrave të sekuestros, të cilat janë përcjellë gjithashtu edhe kreditorëve për dijeni.Gjithashtu, është vijuar me ripërsëritjen e urdhrave të sekuestros edhe për dosjet me objekt kthim shume dhe kontraktuale, duke përcjellë palëve kreditore një kopje të urdhrit të sekuestros për DRASHK Lezhë, me qëllim pagimin e aplikimit për marrjen e informacionit të nevojshëm pranë kësaj drejtorie. | Mungesa e mbështetjes nga IKMT dhe IMT; mungesa e sipërfaqëve te lira për tu pajisur dhe furnizuar plotësisht me tokë për frymë sipas ligjit 7501 ; mungesa e pasurive të palëve debitore dhe mungesa e informacionit të plotë nga DRSHTRR dhe DRASHK Lezhë për çështjet me objekt të vleftësueshëm që bëhet pengese për hetimin shterues pasuror . | Do të evidentohen të gjitha çështjet sipas rubrikave në mënyrë që brenda afatit përkatëse ti jepet zgjidhje ligjore dhe të ulet numri i dosjeve të mbartura . M.Cenaj ka qënë me leje në muajin korrik dhe është kthyer në punë me datë 22.07.2025. Përmbaruesja gjyqësore R.Prenga është me leje nga data 04 gusht dhe në vijim dhe kjo ka ndikuar pak në realizimin e ketij plani për muajin korrik. | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Kukës | Veprimtaria e përmbarueses gjyqësore /kryetare zyrë ka qënë venia e urdhrave të sekuestros në bankat e nivelit të dytë, DRSHTRR dhe DRT, ASHK. | Një pjesë e debitorëve janë nëpër burgje, një pjesë tjetër e debitorëve ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. | Përmbaruesi gjyqësor kryen takime dhe komunikime me Inspektorët e Njësive Administrative të Bashkisë Kukës dhe Has për njoftimin e debitorëve ose dhe të familjareve të tyre për paraqitjen pranë zyrës se përmbarimit Kukes | Në proces. |
| ZP Mat | Janë klasifikuar të gjitha dosjet | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Gjatë muajit Nëntor Zyra përmbarimore Krujë ka vijuar me procesin e klasifikimit të dosjeve me prioritet duke filluar nga dosjet me objekt gjoba penale, duke vijuar me zbatimin e ligjit te aminstise 33/2024, si dhe dosjet ku gjen zbatim ligji Nr.127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative” sipas VKM Nr.274 datë 09.05.2025. | Mos pasja e një informacionin më te shpejte nga institucionet konkretisht kreditorët për ti dhene një zgjidhje ligjore. | Do të vijohet me përsëritjen e kërkesave për ti dhënë një zgjidhje ligjore dosjeve | Në proces |
| ZP Pogradec | është bërë klasifiimi i pothuajse të gjitha dosjet e mbartura fillimisht sipas objekteve gjatë muajit nëntor | nuk kemi hasur problematika | Janë evidentuar të gjitha duke i klasifikuar ato sipas objekteve | realizuar |
| ZP Përmet | është bërë klasifiimi i të gjitha dosjeve të mbartura fillimisht sipas objekteve gjatë muajit Dhjetor. | nuk kemi hasur problematika | | realizuar |

**Masa: 1.1.2 Evidentimi i dosjeve përmbarimore të mbartura më prioritare për t’u dhënë zgjidhje ligjore.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Prioritare për ti dhene zgjidhje ligjore nga Zyra përmbarimore Durrës ka qënë përfituesit e aminstit dhe përfituesit e ligjit për shfuqëzimin e gjobave administrative pasi ka një numër të lart të dosjeve me këto objekte. | Nuk po hasen problematika pas është në fazën përfundimtare ku është bërë evidentimi dhe gjithashtu kërkesa institucioneve për dhënien e informacionit ne jan apo jo përfitues pala nga ligji dhe aminstia. | Do të vijohet me procedurat përmbarimore për çdo dosje që na është dhene informacioni duke i dhen një zgjidhje ligjore. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | Janë evidentuar dosjet përmbarimore që lidhen me pronësinë dhe kthim shume | mungesa e pasurive te mundshme për sekuestrim | përseritje e urdhërave të sekuestros konservative dhe kërkesë për mbështëtje institucioneve | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | kthim shume kontraktuale 1 çështje është në ekzekutim dhe po vijojm me likujdimin e pjesshem te detyrimit ; çështjet me objekt shpenzime gjyqësore te palikujduara janë kerkuar nepërmjet policisë 6 çështje ; | mungesa e pasurive të palëve debitore dhe mungesa e informacionit të plotë nga DRSHTRR dhe DRASHK Pukë për çështjet me objekt te vleftesueshem që bëhet pengese për hetimin shterues pasuror . | do të procedohet sipas rastit dhe përgjigjeve që do të administrohen institucionet te cilave u janë drejtuar. | në proces |
| ZP Elbasan | Është duke u bërë evidentimi i dosjeve për të cilat janë kryer të gjitha proçedurat përmbarimore | Mos marrja e informacionit pranë ASHK-së nëse ka pasuri të paluajtëshme dhe mos vendosja e Sekuestros Konservative në ASHK dhe DRSHTR | Kjo zyrë ka vazhduar me apklim te ne portalin ealbania sipas modulit te ASHK | në proces |
| ZP Lushnjë | Është bërë evidentimi i dosjeve për të cilat janë kryer të gjitha proçedurat përmbarimore | Mos marrja e informacionit pranë ASHK-së nëse ka pasuri të paluajtëshme dhe mos vendosja e Sekuestros Konservative në ASHK dhe DRSHTR | Fillimisht i është bërë shkresë Policisë së Shtetit për lokalizimin e debitorëve që të paraqiten në Zyrën e Përmbarimit me qëllim shlyerjen e detyrimit. Janë njoftuar me shkresë palët kreditore nëse kan interes në ekzekutimin e dosjeve | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | Është bërë përcaktimi i prioriteteve në ekzekutim duke u përzgjedhur për trajtim me përparesi dosjet me me shumë kohezgjatje në ekzekutim për të cilat palët kreditore nuk kanë shfaqur intres prej kohësh. | Nuk kemi hasur asnjë problematikë për realizimin e kësaj masë | | realizuar |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100% prej muajit korrik 2025 | | | I realizuar |
| ZP Fier | Dojset priotare janë evidentuar të gjitha. | Volumi I punës | Pezullimi në rastet kur hetimi përmbarimor është shterues dhe debitori nuk ka pasuri.Marrëveshje dhe me kreditorët për pezullimin e çështjes dhe hapjen ne një moment të dytë pas ballafaqimit me dokumentacionin ligjor. | Në proces |
| ZP Sarandë | Dosjet me prioritare janë ato që kanë me gjatë në ekzekutim. | Nuk ka problem për të bërë evidentimin e tyre | do rievidentohen serish dosjet me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore për to | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Gjirokastër | Tek evidentimi i dosjeve përmbarimore të mbartura më prioritare për Zyrën Përmbarimore Gjirokastër ka qënë evidentimi i dosjeve përmbarimore me Objekt: Gjoba Penale, përfitues të Ligjit të Amnistisë, si dhe evidentimi i dosjeve përmbarimore me Objekt : Gjoba Administrative, përfitues të Ligjit për Shfuqizimin e Gjobave Administrative, pasi ka një numër të lartë të dosjeve përmbarimore me këto objekte. | Nuk janë hasur problematika në evidentimin e tyre si dhe janë në fazën përfundimtare, ku pasi ka përfunduar evidentimi I tyre I janë dërguar shkresa kërkesa institucioneve përkatëse për të na siguruar informacionin nëse janë përfitues të Ligjit të Amnistisë për Gjobat Penale, si dhe përfitues të Ligjit për Shfuqizimin e Gjobave Administrative për Gjobat Administrative | Është vijuar me kryerjen apo ndjekjen e procedurave përmbarimore për çdo dosje përmbarimore, për të cilën disponojmë informacionin, për t'i dhënë zgjidhje ligjore. | Në proces |
| ZP Tropojë | Evidentim i plotë | Nuk kemi pasur Problematika . | | I realizuar 100% |
| Zyrat Vendore Përmbarimore Tiranë | Të gjitha dosjet përmbarimore të mbartura janë vene periodikisht ne levizje nga secili prej përmbaruesve te zyrës se Tiranës dhe numrin më të lartë të dosjeve të mbartura e ze shteti kreditor dhe me konkretisht shpenzimet proceduriale-gjyqësore dhe gjobat penale e adminsitrative . Fokusi kryesor kanë qënë gjobat penale edhe pse me Prokurorine e Tiranë nuk kemi gjetur dot një gjuhe te përbashket nen frymen e nenit 616 te K.Pr.C ndërsa me Porkurorite e Rretheve jemi njoftuar kryesisht me shkresë nga ana e tyre për ato raste që debitorët ishin përfitues dhe që u është kerkuar nga ana jone nëse përfitojnë nga Ligji 33/2024 . Gjithashtu çështjet kontraktuale private dhe shteti deditor si dhe shteti kreditor gjobë admimsitrative janë çështje që kanë një numër te konsiderueshem dhe për të cilat janë ndjekur vpëriemt proceduriale te nevojshme . | Numri i lartë i dosjeve përmbarimore që ka në ngarkim secili përmbarues,mungesa e bashkëpunimit me palët kreditore, kryesisht Prokuroria e Tiranës. | Do të vijohet me evidentimin për pjesën e mbetur të dosjeve përmbarimore. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | Në proces. |
| ZP Dibër | | | Jemi në pritje nga institucioni përkates lidhur me interesin e ekzekutimit te titujve ekzekutiv. | Në proces. |
| ZP Shkodër | Tek evidentimi i dosjeve përmbarimore të mbartura më prioritare për Zyrën Përmbarimore Shkodër ka qënë evidentimi i dosjeve përmbarimore me Objekt: shpenzime proceduriale dhe gjoba administrative te Policisë Kufitare dhe Doganes. | Nuk janë hasur problematika në evidentimin e tyre si dhe janë në fazën përfundimtare, ku pasi ka përfunduar evidentimi I tyre I janë dërguar shkresa kërkesa institucioneve përkatëse. | Do të vazhdohet me kryerjen apo ndjekjen e procedurave përmbarimore për çdo dosje përmbarimore, për të cilën disponojmë informacionin, për t'i dhënë zgjidhje ligjore. | Në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Gjithashtu, është vijuar me ripërsëritjen e urdhrave të sekuestros edhe për dosjet me objekt kthim shume dhe kontraktuale, duke i përcjellë palëve kreditore një kopje të urdhrit të sekuestros për DRASHK Lezhë, me qëllim realizimin e aplikimit për marrjen e informacionit të nevojshëm pranë kësaj drejtorie. Nga ana tjetër, kemi marrë përgjigje nga Prokuroria e Lezhës, në cilësinë e kreditorit, se ata nuk disponojnë fonde për pagesën e vendimeve penale dhe, për këtë arsye, nuk mund të bëjnë aplikim. | mungesa e mbështëtje nga IKMT dhe IMT; mungesa e sipërfaqëve te lira për tu pajisur dhe furnizuar plotësisht me tokë për frymë sipas ligjit 7501 ; mungesa e pasurive të palëve debitore dhe mungesa e informacionit të plotë nga DRSHTRR dhe DRASHK Lezhë për çështjet me objekt te vleftësueshem që bëhet pengesë për hetimin shterues pasuror . Është vijuar gjithashtu me verifikimin e çështjeve me objekt takim fëmije dhe pension ushqimor, për rastet kur fëmijët kanë mbushur moshën madhore dhe, sipas rastit, nuk vazhdojnë arsimin e lartë.<br>Janë evidentuar gjithashtu dosjet për të cilat janë paguar faturat e aplikimit pranë DRASHK Lezhë. | do të procedohet sipas rastit dhe përgjigjeve që do të administrohen institucionet te cilave u janë drejtuar. | në proces |
| ZP Kukës | Të gjitha dosjet janë prioritare pasi duhet të respektohen afatet për t'u dhënë zgjidhje ligjore. | | | Në proces. |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Gjatë muajit Nëntor Zyra Përmbarimore Krujë ka vijuar me procesin e klasifikimit të dosjeve me prioritet duke filluar nga dosjet me objekt gjoba penale, duke vijuar me zbatimin e ligjit të aminstisë 33/2024,si dhe dosjet ku gjen zbatim ligji Nr.127/2024 "Për shfuqizimin e masave administrative" sipas VKM Nr.274 datë 09.05.2025 | kreditori vonon në kthim përgjigje në lidhje me dosjet ku bëhet aplikimi ligjit për amnistinë. | konfirmimi nga ana e kreditorit nëse dojsa duhet të pushohet si rrjedhojë e përfitimit të amnistisë | Në proces |
| ZP Pogradec | Gjykojmë se dosjet më prioritare janë ato që kanë më gjatë në ekzekutim dhe këto jemi duke i evidentuar | Nuk ka problematika për të bërë evidentimin e tyre | do rievidentohen sërish dosjet me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore për to | në proces |
| ZP Përmet | Dosjet më prioritare janë ato që kanë më gjatë në ekzekutim. | Nuk ka problem për të bërë evidentimin e tyre | do rievidentohen sërish dosjet me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore për to | në proces |

<table>
<tr><td colspan="3">Masa Nr.1.2<br>Njoftimi i palëve kreditore për shprehje interesi në ekzekutim.</td></tr>
<tr><td>Përshkrimi i problemit:</td><td colspan="2">Një numër i madh i dosjeve përmbarimore qëndrojnë aktive prej vitesh ndërkohë që nga pala kreditore, veçanërisht kur është subjekt privat nuk tregohet asnjë interes mbi ekzekutimin e titujve ekzekutivë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.2.1 T'u dërgohen kreditorëve brenda tre muajve dy njoftime shkresore, për të konfirmuar interesin mbi ekzekutimin e titujve ekzekutivë.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.2.2 Nëse nga pala kreditore nuk përgjigjet brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësohet pezullimi i dosjes përmbarimore në zbatim të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Kompetenca:</td><td>Institucion përgjegjës</td><td>Institucion kontribues</td></tr>
<tr><td>22 Zyrat Vendore Përmbarimore</td><td></td></tr>
<tr><td>Burimet:</td><td>Kryetarët dhe Përmbaruesit gjyqësor shtetërorë</td><td></td></tr>
<tr><td>Koha:</td><td>Kohëzgjatja: 1 vit nga koha e miratimit</td><td>Faza :</td></tr>
</table>

**Masa 1.2  Njoftimi i palëve kreditore për shprehje interesi në ekzekutim.**

**Progresi**

Gjatë periudhës raportuese, është vijuar procesi i njoftimit të palëve kreditore për të konfirmuar interesin në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me synim reduktimin progresiv të stokut të dosjeve të mbartura. Janë identifikuar të gjitha dosjet përmbarimore me palë kreditore, duke përfshirë dosjet kontraktuale private, gjobat penale, gjobat administrative, shpenzimet procedural.
Nga përmbaruesit gjyqësorë janë dërguar njoftime shkresore për të konfirmuar interesin në vijimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, sipas nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile. Në disa raste, për shkak të mungesës së përgjigjeve ose mosparaqitjes së kreditoreve brenda afatit të përcaktuar, është kërkuar bashkëpunim me institucionet përkatëse (AMGKP, IMT, DRASHK, pushtet vendor, Gjendja Civile) për marrjen e informacionit të nevojshëm. Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar administrimin e përgjigjeve të palëve kreditore, duke dhënë zgjidhje ligjore për rastet ku detyrimi është shlyer ose marrëdhënia juridike është zgjidhur me marrëveshje ndërmjet palëve.
Për dosjet ku kreditorët nuk kanë shprehur interes, janë pezulluar procedurat në përputhje me nenin 615/dh të K.Pr.Civile. Pas përfundimit të afatit 3-mujor, do të vlerësohet vijimi ose zgjidhja ligjore për secilin rast. Procesi i njoftimit dhe administrimit të përgjigjeve vazhdon për disa dosje të stokut të mbartura ndër vite.

**Problematikat**

- Mungesa e adresave të sakta të palëve kreditore, që rezulton në kthimin e zarfeve me shënimin “larguar” ose mosmarrjen e njoftimit.
- Numri i lartë i dosjeve të mbartura ndër vite, që rëndon kapacitetin e përmbaruesve për zbatimin brenda afateve.
- Mungesa e të dhënave të plota të kreditorëve (gjeneralitete), duke kërkuar komunikime shtesë me Gjendjen Civile, AMGKP etj.
- Vonesat në kthimin e përgjigjeve nga institucionet bashkëpunuese.
- Vështirësi procedurale në çështje të veçanta, si p.sh. pensionet ushqimore, për shkak të ndryshimeve të adresës dhe mbiemrit të palëve.

**Hapat në vijim**

- Përfundimi i dërgimit të njoftimeve të dyta shkresore në të gjitha zyrat.
- Kërkesa dhe verifikimi i adresave të sakta pranë institucioneve përkatëse për të gjitha rastet problematike.
- Përdorimi i kanaleve alternative të njoftimit (bashkëpunim me Policinë e Shtetit, njoftim elektronik ku është e mundur).
- Vlerësimi dhe vendimmarrja për pezullimin e dosjeve sipas nenit 615/dh për ato raste ku nuk ka përgjigje brenda afatit ligjor.
- Monitorim dhe raportim periodik mbi ecurinë dhe përqindjen e realizimit në çdo zyrë vendore.

**Statusi**

Procesi është në zhvillim, me disa zyra në fazë përfundimtare dhe të tjera ende në fazën e parë të njoftimit. Ka progres të dukshëm në disa qarqë, ndërsa në të tjera kërkohet intensifikim i punës dhe koordinim më i mirë ndërinstitucional.

**Masa: 1.2.1 T’u dërgohen kreditorëve brenda tre muajve dy njoftime shkresore, për të konfirmuar interesin mbi ekzekutimin e titujve ekzekutivë.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Zyra Përmbarimore Durrës duke pasur dhe një numër të lart dosjesh është mundur që përveç dosjeve që i është dhënë prioritet të bëj dhe njoftimin e palëve kreditore për të shprehur interesin në ekzekutim. | Nuk ka problematika specifike të evidentuara në këtë proces | Do të vijohet me njoftimin e çdo palë kreditore. | Në proces |
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës është në fazën e evidentimit të dosjeve që kan palë kreditore në të tilla raste që janë me palë dhe që të vijohet me njoftimin shkresor. | Problematikat që hasen ne këto raste është vetëm mos pasia e një adresë të saktë pasi komunikimi shkresor gjithmonë mbetet problematik pasi mund dhe të mos merret nga palët. | Do të vijohet me njoftimin shkresor. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | I jemi drejtuar me shkresë për informacion AMGKP-se për debitorët pasi nuk kemi gjeneralitetet e plota. Gjithashtu shkresë dhe IMT-se në rast se përfitojnë nga VKM nr 274 datë 09.05.2025 | mosgjetja e adresave dhe e generaliteteve nga ana e Zyrave të Gjendjes Civile | përseritje e shkresave për gjeneralitetet e debitorëve në rastet e moskthimit te përgjigjes | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbari more Pukë | kemi njoftuar palët kreditore për pagim të aplikimeve të bëra në DRASHK ; | nëse nuk depozitojnë përgjigje do t`u ridërgojmë edhe një kërkesë të dytë | | në proces |
| ZP Elbasan | Janë njoftuar palët kreditore për shprehje interesi në ekzekutim kryesisht për dosjet kontraktuale, Gjoba penale, një pjesë e gjobave administrative dhe një pjesë e shpenzimeve proceduriale | Mos marrja e informacionit pranë ASHK nëse ka pasuri të paluajtshme dhe mos vendosja e Sekuestros Konservative në ASHK dhe DRSHTR si dhe disa palë private rezultojnë të larguara | Janë njoftuar palët kreditore për shprehje interesi në ekzekutim, gjithashtu nëpërmjet Policisë se Shtetit është njofuar një pjesë e debitorëve që të paraqiten për të shlyer detyrimet | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë njoftuar palët kreditore për shprehje interesi në ekzekutim kryesisht për dosjet kontraktuale, Gjoba penale, një pjesë e gjobave administrative dhe një pjesë e shpenzimeve proceduriale | Mos marrja e informacionit pranë ASHK nëse ka pasuri të paluajtshme dhe mos vendosja e Sekuestros Konservative në ASHK dhe DRSHTR si dhe disa palë private rezultojnë të larguara | Janë njoftuar palët kreditore për shprehje interesi në ekzekutim., gjithashtu nëpërmjet Policisë se Shtetit është njofuar një pjesë e debitorëve që të paraqiten për të shlyer detyrimet. | në proces |
| ZP Vlorë | Me synim reduktimin progresiv të stokut janë evidentuar dosjet përmbarimore kur subjektet kreditore nuk kanë treguar interes mbi ekzekutimin e titujve ekzekutivë. U është bërë njoftim për paraqitje kreditorëve në zbatim të nenit 615/dh te K.Pr.C | Kemi hasur probleme kryesisht me adresat | I jemi drejtuar ZGJC për saktësimin e adresave dhe pasi të sigurohen adresat përkatëse, do të vijohet me dërgimin e kërkesave kreditorëve për tu paraqitur | përfunduar |
| ZP Korçë | Ka vijuar puna duke ju dërguar palëve kreditore njoftime shkresore kryesisht në dosjet e vjetra me objekt pension ushqimor, ku palët kreditore ftohen të konfirmojnë interesin për vijimin e ekzekutimit. Për palët kreditore që nuk kanë marrë dijeni, kemi kërkuar bashkëpunimin e Komisariatit të Policisë Korçë, të pushtetit vendor si dhe Gjendjes Civile. Disa kreditore i janë përgjigjur thirje sone, duke u paraqitur pranë zyrës duke kerkuar pushimin e procedurës së ekzekutimit, për shkak se detyrimi objekt ekzekutimi është shlyer plotësisht, ose se marrëdhënia juridike është zgjidhur jashtë kësaj zyrë, nëpërmjet marrëveshjes ndërmjet palëve. | Mungesa e të dhenave të përditesuara të kontaktit për një pjesë të konsiderueshme të kreditoreve (ndryshim adresë). Një pjesë e konsiderueshme e njoftimeve janë kthyer nga posta për arsye të ndryshme (adresë e pasakte, larguar jashtë shtetit,etj.) | Rishikim i plotë i dokumentacionit për të evidentuar rastet ku janë përmbushur kushtet për dërgimin e njoftimit të dytë shkresor si dhe rastet kur pavarësisht njoftimit të përsëritur pala kreditore nuk ka shprehur interes, duke krijuar premisa për vleresimin e pezullimit të tyre bazuar në masën 1.2.2 dhe nenit 615/dh të K.Pr.Civile. Do vijohet me dërgimin e njoftimeve shkresore. Në bashkëpunim dhe me instuticionet kompetente do të sigurohen të dhëna të përditesuara për palët që nuk marrin njoftim. | Në proces |
| ZP Fier | Për dosjet e ndryshme kemi ecur pothuajse 100 %. Buxhet shteti është punuar me shumë me debitorët. | Volumi i punës | Për dosjet e ndryshme do punohet me kreditorët.Për buxhet shteti do punojme me tepër me debitorët.Me dosjet buxhet shteti është punuar me debitorët dhe kemi arritur rezultat janë ekzekutuar mbi 50 dosje të mbartura. | Realizuar pjesërisht si dhe në proces. |
| ZP Sarandë | | një pjesë e kreditoreve nuk kanë adresë të saktë | do rikërkohet adres ne gjendjen civile dhe ne komisariate | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Gjirokastër | Zyra e Përmbarimit Gjirokastër ka bërë të mundur evidentimin e dosjeve të mbartura për të dërguar shkresa drejtuar palëve kreditore për të konfirmuar interesin e tyre për ekzekutimin e titujve ekzekutiv | shumica e palëve kreditore nuk rezultojnë të kenë adresë të saktë e verifikuar nga shërbimi postar | Janë ridërguar kërkesa drejtuar gjendjes civile për saktësimin e adresave të palëve | në proces |
| ZP Tropojë | Ezauruar si veprime. | Nuk kemi pasur problematika . | Nuk ka asnjë dosje në ekzekutim | |
| Zyra Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me evidentimin dhe kërkesat drejtuar palëve kreditore për shprehje interesi, përsa i përket dosjeve të mbartura prej vitesh. Aktualisht jemi në fazën që po presim dhe administrojmë përgjigjet e palëve kreditore | Numri i lartë i dosjeve përmbarimore që ka në ngarkim secili përmbarues, e bën të vështirë realizimin e kètij hapi, gjithashtu mungesa e adresave të sakta të palëve kreditore. | Do të vijohet me njoftimin e palëve kreditore | Në proces |
| ZP Shkodër | Zyra e Përmbarimit Shkodër ka bërë të mundur evidentimin e dosjeve të mbartura për të dërguar shkresa drejtuar palëve kreditore për të konfirmuar interesin e tyre për ekzekutimin e titujve ekzekutivë | shumica e palëve kreditore nuk rezultojnë të kenë adresë të saktë e verifikuar nga shërbimi postar | Do ridërgohen kërkesa drejtuar gjendjes civile për saktësimin e adresave të palëve | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Janë evidentuar gjithashtu dosjet për të cilat janë paguar faturat e aplikimit pranë DRASHK Lezhë | nëse nuk depozitojnë përgjigje do t`u ridërgojme edhe një kërkese të dytë | | në proces |
| ZP Kukës | Jemi drejtuar kreditoreve me njoftime shkresë për konfirmuar interesin lidhur me ekzekutimin e titujve ekzekutiv. | | Jemi në pritje nga institucioni përkatës lidhur me interesin e ekzekutimit te titujve ekzekutivë. | Në proces. |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë duke pasur një numër të lart dosjesh të mbartura ndër vite vijon me njoftimin e kreditoreve me shkresa te përsëritura. | Adresa jo e saktë e pasi komunikimi shkresor gjithmonë mbetet problematik pasi mund dhe të mos merret nga palët. | Do të vijohet me njoftimin shkresor. | Në proces |
| ZP Pogradec | pasi janë evidentuar dosjet e mbartura një pjesë e tyre janë parë edhe kur kreditori nuk ka paraqitur interes është vijuar me shkresa të dyta dhe për ato dosje që ka kaluar ky afat iu është dhënë zgjidhje ligjore | një pjesë e kreditore nuk kanë adresë të saktë apo ndodhen jashtë shtetit | do rikërkohet adresë në gjendjen cicile dhe në komisariate | në proces |
| ZP Përmet | | një pjesë e kreditoreve nuk kanë adresë të saktë | do rikërkohet adresa në gjendjen civile dhe në komisariate | në proces |

**Masa: 1.2.2 Nëse nga pala kreditore nuk përgjigjet brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësohet pezullimi i dosjes përmbarimore në zbatim të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Do të vijohet me pezullimin në zbatim të nenit 615/dh të Kodit Procedures Civile. | Nuk ka ende problematakia të evidentuara. | Do të vijohet në zbatimin e nenit 615/dh K.Pr.Civile | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | kërkesë e përsëritur AMGKP-se për informacion për debitorët | IMT-Bashkia Lezhë nuk ka kthyer përgjigje | pezullim në zbatim të nenit 615/dh | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | | | | në proces |
| ZP Elbasan | Janë njoftuar palët kreditore për shprehje interesi në ekzekutim | Rezulton se disa palë kreditore nuk e kan marrë njoftimin pasi zarfet janë kthyer mbrapsht me mbishkrimin larguar dhe adresat nuk gjenden | Pas mbushjes se afatit ligjor 3 mujor të njoftimit të dytë të kreditorëve që kanë marr njoftimin do të procedohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë njoftuar palët kreditore për shprehje interesi në ekzekutim | Rezulton se disa palë kreditore nuk e kan marr njoftimin pasi zarfet janë kthyer mbrapsht me mbishkrimin larguar | Pas mbushjes se afatit ligjor 3 mujor të njoftimit të dytë të kreditorëve që kanë marr njoftimin do të procedohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | përfunduar | ngelen adresat problem | Do të veprohet sipas udhëzimit 1.2.2 të Planit të Punës | përfunduar |
| ZP Korçë | Përgjatë muajit dhjetor janë pezulluar një sërë dosjesh përmbarimore në bazë të nenit 615/dh te K.Pr.Civile. | | Për dosjet pa interes aktiv nga pala kreditore do të vijoj sipas ligjit dhe planit te punës, pezullimi i dosjes përmbarimore, bazuar në nenin 615/dh të Kodit të Procedurës Civile. | Në proces |
| ZP Fier | Për dosjet e ndryshme kemi ecur pothuajse 100 %. Buxhet shteti është punuar më shumë me debitorët. | Volumi i punës | Do vazhdojnë njoftimet | Realizuar pjesërisht si dhe në proces. |
| ZP Sarandë | do vlerësohet pezullimi pasi të kalojë afati 3 mujor rast pas rasti | | do vijohet me shkresa për kreditorët dhe nëse ata nuk kanë intesres do ripërseritet për t'i dhënë më pas zgjidhje ligjore dosjeve të mbartura | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Gjirokastër | është bërë evidentimi i dosjeve përmbarimore si dhe njoftimet drejtuar palëve | një pjesë e kreditoreve nuk është përgjigjur, problematika lidhur me adresat e pasakta të palëve | do të vijohet me pezullimin e dosjeve përmbarimore pas kalimit të afatit 3 mujor nga njoftimi i dytë shkresor | në proces |
| ZP Tropojë | | Nuk kemi pasur Problematika . | Nuk ka asnjë dosje në ekzekutim | |
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | Përnbaruesit gjyqësor kanë vijuar me kërkesat drejtuar kreditorëve. Aktualisht jemi në fazën e administrimit të përgjigjeve të tyre por ka akoma dosje për të cilat po procedojmë me dërgimin e kërkesave për të gjitha dosjet e stokut ndër vite. | Duke patur parasysh numrin e lartë të dosjeve, kjo e vështirëson vijimin e punës, kemi hasur pengesa në njoftimin e kreditorëve për shkak të adresave të pasakta. | Do të vijohet me njoftimin e palëve kreditore si dhe me kërkesat për saktësimin e adresave të tyre.Gjithashtu do të çmohet nëse jemi para pezullimit sipas nenit 615/dh të K.Pr.C . | Në proces |
| ZP Dibër | | | Në rastet kur pala kreditore nuk do të përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi shkresor të bërë nga përmbaruesi gjyqësor do të procedohet në bazë të nenit 615/dh të Kodit Pr.Civile. | |
| ZP Shkodër | Është bërë evidentimi i dosjeve përmbarimore si dhe njoftimet drejtuar palëve | një pjesë e kreditoreve nuk është përgjigjur, problematika lidhur me adresat e pasakta të palëve | do të vijohet me pezullimin e dosjeve përmbarimore pas kalimit të afatit 3 mujor nga njoftimi i dytë shkresor | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | | | | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Është vijuar me përsëritjen e shkresave duke pritur konfirmimin e tyre para se të arrihet në zbatim neni 615/dh K.Pr.C | adresa jo e saktë dhe përsëritja e shkresave. | Do të vijohet në zbatimin e nenit 615/dh K.Pr.Civile | Në proces |
| ZP Pogradec | do vlerësohet pezullimi pasi të kaloj afati 3 mujor rast pas rasti | një pjesë e kreditorëve nuk është përgjigjur | do vijohet me shkresa për kreditorët dhe nëse nuk kanë interes do ripërseritet për ti dhënë më pas zgjidhje ligjore dosjeve të mbartura | në proces |
| ZP Përmet | do vlerësohet pezullimi pasi të kalojë afati 3 mujor rast pas rasti | | do vijohet me shkresa për kreditorët dhe nëse ata nuk kanë interes do ripërseritet për ti dhënë më pas zgjidhje ligjore dosjeve të mbartura | në proces |

| | | |
|---|---|---|
| **Masa Nr.1.3**<br>**Trajtimi i dosjeve përmbarimore me objekt “gjobë penale” ku pala debitore është subjekt që përfiton nga Ligji “Për Amnistinë”.** | | |
| **Përshkrimi i problemit:** | Pjesa më e madhe e dosjeve përmbarimore të mbartura janë me objekt “gjoba penale”, nga të cilat shumë debitorë janë subjekte që kanë përfituar nga ligji për amnistinë. | |
| **Masa: 1.3.1 Hartimi i një liste me dosjet përmbarimore ku pala debitore është subjekt që përfiton nga amnistia.** | | |
| **Masa: 1.3.2 Dërgimi i listës prokurisë kompetente për kërkesë për pushim (neni 616/b të K.Pr.C) ose vendim për shfuqizim të gjobës nga gjykata kompetente.** | | |
| **Masa: 1.3.3 Në rast se nga prokuroria përkatëse (shteti kreditor) nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësoshet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.** | | |
| **Kompetenca:** | **Institucion përgjegjës** | **Institucion kontribues** |
| | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | Prokuroria |
| **Burimet:** | Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë | |
| **Koha:** | Kohezgjatja: 2025-2030 | Faza : |

**Masa 1.3 Trajtimi i dosjeve përmbarimore me objekt “gjobë penale” ku pala debitore është subjekt që përfiton nga Ligji “Për Amnistinë”.**

**Progresi**

Gjatë vitit 2025, fokusi ka qënë evidentimi dhe trajtimi i të gjitha dosjeve përmbarimore me objekt gjoba penale, ku debitorët janë subjekte që përfitojnë nga Ligji nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”. Nga zyrat përmbarimore vendore janë evidentuar të gjitha dosjet përmbarimore me objekt gjoba penale, ku debitorët përfitojnë nga amnistia. Për secilin subjekt është hartuar lista e dosjeve dhe është dërguar në prokuroritë kompetente për verifikim dhe pushim të ekzekutimit sipas nenit 616/b të Kodit të Procedurës Civile. Listat janë dërguar në përiudhën prill – dhjetor 2025, duke përfshirë të gjitha dosjet që kërkonin shqyrtim për amnistinë. Për subjektet që nuk kanë pasur përgjigje të menjëhershme, procesi është ndjekur dhe administruar deri në marrjen e vendimeve për pushim të ekzekutimit. Bazuar në vendimet e prokurorive, janë pushuar çështje me gjoba penale për subjektet përfitues të amnistisë.

**Problematikat**

- Vonesa ose mungesë përgjigjeje nga disa prokurori, pavarësisht përsëritjes së kërkesave.

- Numri i lartë i dosjeve të mbartura, që ngarkon kapacitetin e përmbaruesve dhe zgjat afatet e përfundimit të procedurës.
- Mungesa e bashkëpunimit të plotë ndërinstitucional, duke krijuar pengesa për zgjidhje ligjore të menjëhershme.
- Në disa zyra, nuk ka dosje gjobash penale që përfitojnë nga amnistia.

**Hapat në vijim**

- Përfundimi i dërgimit të listave për të gjitha dosjet që nuk janë trajtuar ende.
- Ndjekja e vazhdueshme e prokurorive që nuk kanë kthyer përgjigje, përmes komunikimit të përsëritur dhe kërkesave zyrtare.
- Procedimi me pezullimin e dosjeve sipas nenit 615/dh për rastet pa përgjigje brenda afatit ligjor.

**Statusi**

Procesi është kryesisht i avancuar në pjesën më të madhe të zyrave vendore, me shumicën e dosjeve tashmë të pushuara, por me disa zyra ende në pritje të përgjigjes nga prokuroritë. Në disa zyra, procedurat e pezullimit janë në zhvillim.

**Masa: 1.3.1 Hartimi i një liste me dosjet përmbarimore ku pala debitore është subjekt që përfiton nga amnistia.**

| 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës gjatë kësaj kohe ka bërë listën ku ja ka komunikuar për çdo subjekt prokurorive përkatëse. | Problematikat që hasen në këto raste është vetëm pritja nga ana e organit të prokurorisë për dhënien e informacionit pasi ka dhe kërkesa të përsëritura. | Po vijohet me procedurën deri në dosjen e fundit për subjektet përfituese nga aminstia. | Realizuar |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | nuk ka gjoba penale aktive subjekt te Amnistisë | | | realizuar |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | nuk kemi çështje aktive në ekzekutim gjoba penale pasi i kemi realizuar në vitin 2024 | - | | realizuar |
| ZP Elbasan | Janë evidentuar të gjitha dosjet me objekt gjoba penale | Kjo zyrë nuk ka dosje përmbarimore me objekt Gjoba penale te cilat kanë përfituar nga Ligji"Për Amnistinë" | | realizuar |
| ZP Lushnjë | Janë evidentuar të gjitha dosjet me objekt gjoba penale | Prokuroria Durrës dhe Prokuroria Elbasan nuk kanë kthyer asnjë përgjigje në lidhje me kërkesat që i janë drejtuar nga Zyra e Përmbarimit Lushnje | Pas mbushjes së afatit ligjor 3 mujor të njoftimit të dytë të kreditorëve që kanë marr njoftimin do të | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | procedohet sipas nenit 615/dh | |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | I është bërë kërkesë prokurorisë dhe jemi në pritje të listës të subjekteve që përfitojnë nga amnisia për gjoba penale në zbatim Ligji nr.33/2024 "Për dhënie amnistie" | | | Në proces |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100% prej muajit korrik 2025 | | | I realizuar |
| ZP Fier | Dërguar lista prokurorive kompetente.Për disa është vendosur amnistia.Për disa nuk kemi marrë përgjigje. | Problematikë është se jo të gjitha prokuritë kanë kthyer përgjigje | Do ripërsëritet dhe njëherë kërkesa. | Realizuar pjesërisht si dhe në proces. |
| ZP Sarandë | është bërë dërgimi listës në prokurori që në muajin korrik 2025. | Prokuroria Gjirokastër ende nuk ka përcaktuar debitorët që përfitojnë nga amnistia. | | proces |
| ZP Gjirokastër | është bërë hartimi për dërgimin e listës në prokurori që në muajin prill-korrik 2025 në prokuroritë përkatëse | kemi pasur bashkëpunim institucional | | realizuar |
| ZP Tropojë | Klasifikim i plotë. | Nuk kemi pasur Problematika . | Të gjitha dosjet janë pushuar. | |
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me hartimin e listave me dosjet përmbarimore ku pala debitore është subjekt që përfiton nga amnistia.Kemi proceduar me pushimin e 59 çështjeve me objekt gjobë penale me kërkesë të prokurorive | Numri i lartë i dosjeve përmbarimore që ka në ngarkim secili përmbarues, e kanë ngadalësuar realizimin e këtij hapi, mungesa e theksuar e bashkëpunimit nga disa Prokurori kanë krijuar pengesa në dhënien e zgjidhjes ligjore përfundimtare të këtyre rasteve. | Do të vijohet me hartimin e listave për dosjet e mbetura. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | I realizuar. |
| ZP Shkodër | Është dërguar lista nga Prokuroria Shkodër dhe I M T Bashkia Shkodër. | kemi pasur bashkëpunim institucional | | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | nuk kemi çështje aktive në ekzekutim gjoba penale pasi i kemi realizuar ne vitin 2024 | - | | realizuar |
| ZP Kukës | Dosjet me objekt gjobë penale janë amnistuar. | | | I realizuar. |
| ZP Mat | nuk ka dosje te kësaj kategorie | | | |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë ka hartuar listën dhe ju ka komunikuar për çdo subjekt prokurorive përkatëse. | Problematikat që hasen në këto raste është vetëm pritja nga ana e organit të prokurorisë pra palës kreditore për dhënien e konfirmimin nëse plotëson kushtet për të bërë pushimin e dosjes përfundimisht | Po vijohet me procedurën deri në dosjen e fundit për subjektet përfituese nga aminstia. | Në proces |
| ZP Pogradec | është bërë dërgimi listës në prokurori që në muajin maj 2025 dhe gjatë korrikut janë amnistuar gjobat e fundit | Nuk kemi pasur probleme | | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Përmet | është bërë dërgimi listës në prokurori që në muajin korrik 2025. | Prokuroria Gjirokastër ende nuk ka përcaktuar debitorët që përfitojnë nga amnistia. | | proces |

**Masa: 1.3.2 Dërgimi i listës prokurisë kompetente për kërkesë për pushim (neni 616/b të K.Pr.C) ose vendim për shfuqizim të gjobës nga gjykata kompetente.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës gjatë kësaj kohe ka bërë listën ku ja ka komunikuar për çdo subjekt prokurorive përkatëse. | Problematikat që hasen në këto raste është vetëm pritja nga ana e organit për prokurorinë për dhënien e informacionit pasi ka dhe kërkesa të përsëritura. | Po vijohet me procedurën deri në dosjen e fundit për subjektet përfituese nga aminstia. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | nuk ka gjoba penale aktive subjekt të Amnistisë | | | realizuar |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | nuk kemi çështje aktive në ekzekutim gjoba penale që përfitojnë nga amnistia | | | realizuar |
| ZP Elbasan | Kjo zyrë nuk ka çështje të tilla | Kjo zyrë nuk ka çështje të tilla | Kjo zyrë nuk ka çështje të tilla | realizuar |
| ZP Lushnjë | U janë dërguar prokurorive respektive shkresë për debitorët të cilët përfitojnë nga ligji i amnistisë | Pjesa më e madhe e pokurorive kanë dërguar shkresë për pushimin e dosjeve pasi përfitojnë nga amnistia. Vetëm prokuroria Durrës dhe Elbasan nuk i janë përgjigjur shkresave të nisura | Pas mbushjes së afatit ligjor 3 mujor të njoftimit të dytë të kreditorëve që kanë marr njoftimin do të procedohet sipas nenit 615/dh | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | është dërguar lista | | | përfunduar |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100% prej muajit korrik 2025 | | | I realizuar |
| ZP Fier | | Është punuar me tepër me debitorin.Ka pasur rezultat. | Do njoftohen të gjithë debitorët sipas planit të brendshëm të zyrës pastaj do vijohet me kreditorin | I parealizuar sipas planit të drejtorisë |
| ZP Sarandë | lista është dërguar që në korrik 2025, janë marrë vendimet e pushimit në bazë shkresës se dërguar nga prokurorit në bazë të nenit 616 | nuk kemi pasur probleme | | realizuar |
| ZP Gjirokastër | Është bërë dërgimii i listës në prokurori që në muajin | kemi pasur bashkëpunim institucional | | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | prill-korrik 2025 në prokuroritë përkatëse | | | |
| ZP Tropojë | Klasifikim i Plotë. | Nuk kemi pasur Problematika . | Nuk ka asnjë dosje në ekzekutim | |
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me dërgimin e listave prokurorive kompetente për kërkesë për pushim konform nenit 616/b të K.Pr.C | Numri i lartë i dosjeve përmbarimore që ka në ngarkim secili përmbarues,e kanë ngadalësuar realizimin e këtij hapi, mungesa e përgjigjeve nga ana e palës kreditore ose dhe kundërshtimi i kërkesave të përmbaruesve gjyqësor nga ana e Prokurorisë Tiranë. | Do të vijohet me dërgimin e listave si dhe do të kërkohet mbështetja nga ana e DPP për të na ndihmuar në lidhje me ngërçin institucional të krijjuar. | Në proces |
| ZP Dibër | Lidhur me dërgimin e listës që duhet dërguar prokurorisë kompetente për kërkesën për pushim sipas nenit 616/b të K.Pr.Civile ose për shfuqizimin e gjobës nga gjykata nuk e kemi patur raste të tilla. | | | I parealizuar. |
| ZP Shkodër | Është bërë dërgimii i listës në prokurori që në muajin prill-korrik 2025 në prokuroritë përkatëse | kemi pasur bashkëpunim institucional | | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | nuk kemi çështje aktive në ekzekutim gjoba penale që përfitojnë nga amnistia | | | |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë gjatë kësaj kohe ka bërë listën ku ja ka komunikuar për çdo subjekt prokurorive përkatëse. | Pritja e konfirmimit nga kreditori pasi ka dhe kërkesa të përsëritura. | Po vijohet me procedurën deri në dosjen e fundit për subjektet përfituese nga aminstia. | Në proces |
| ZP Pogradec | Lista është dërguar që në maj 2025, janë marrë vendimet e pushimit në bazë të shkresës së dërguar nga prokurorit në bazë të nenit 616/b | nuk kemi pasur probleme | | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Përmet | lista është dërguar që në korrik 2025, janë marrë vendimet e pushimit në bazë shkresës se dërguar nga prokurorit në bazë të nenit 616 | nuk kemi pasur probleme | | realizuar |

**Masa: 1.3.3 Në rast se nga prokuroria përkatëse (shteti kreditor) nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësoshet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës gjatë kësaj koh ka bërë listën ku ja ka komunikuar për çdo subjekt prokurorive përkatëse. | Problematikat që hasen në këto raste është vetëm pritja nga ana e organit për prokurorit për dhënien e informacionit pasi ka dhe kërkesa të përsëritura. | Pas njoftimit të dytë shkresor brenda tre muajve do të vijohet me pezullimin e dosjes përmbarimore me nenin 615/dh te K.Pr.Civile | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | nuk ka gjoba penale aktive subjekt te Amnistisë | | | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Pukë | - | - | - | |
| ZP Elbasan | Për momentin nuk ka çështje të tilla | Për momentin nuk ka çështje të tilla | Për momentin nuk ka çështje të tilla | - |
| ZP Lushnjë | U janë dërguar prokurorive respektive shkresë për debitorët të cilët përfitojnë nga ligji i amnistisë | Pjesa më e madhe e prokurorive kanë dërguar shkresë për pushimin e dosjeve pasi përfitojnë nga amnistia. Vetëm prokuroria Durrës dhe Elbasan nuk i janë përgjigjur shkresave të nisura | Pas mbushjes se afatit ligjor 3 mujor të njoftimit të dytë të kreditorëve që kanë marr njoftimin do të procedohet sipas nenit 615/dh | realizuar |
| Zyrat Përmbarimore Vlorë | | | | Në proces |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100% prej muajit shtator 2025 | | Sot, në Zyrën e Përmbarimit Korçë rezultojnë dosje në ekzekutim me object "gjobë penale", të cilat janë kryesisht dosje të regjistruara në vitin aktual, për të cilat vijohen veprimet sipas ligjit. | I realizuar |
| ZP Fier | | Është punuar me tepër me debitorin. Ka pasur rezultat. | Do njoftohen të gjithë debitorët sipas planit të brendshëm të zyrës pastaj do vijohet me kreditorin | I parealizuar sipas planit të drejtorisë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Sarandë | | nuk kemi pasur probleme | | proces |
| ZP Gjirokastër | janë dërguar shkresat përkatëse drejtuar prokurorive dhe është konstatuar se disa prej tyre në cilesinë e palës kreditore nuk kanë kthyer përgjigje | është bërë njoftimi dytë shkresor dhe jemi në pritje të përgjigjes | | në proces |
| ZP Tropojë | Ezauruar si Veprime. | Nuk kemi pasur Problematika . | Janë ezauruar veprimet përmbarimore në ekzekutim të titujve ekz. Ku palë kreditore janë Prok. përkatëse. | |
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me dërgimin e listave prokurorive kompetente për kërkesë për pushim konform nenit 616/b të K.Pr.C. Aktualisht jemi në fazën e parë të këtij hapi. | Do të vlerësohet nëse jemi në kushtet për pezullim pasi ligji posacëm për ekzekutimin e vendimeve penale përcakton që prokuroria njoftohet vetëm për fillimin dhe përfundimin e procedurës, pra nuk është e nevojshme ndërhyrja e mëtejshme. | Përmbaruesit gjyqësor do të vlerësojnë imtësisht nëse ndodhemi në kushtet e pezullimit, duke analizuar përveç K.Pr.Civile dhe ligjin e posaçëm për ekzekutimin e vendimeve penale | Në proces |
| ZP Dibër | | | | Në proces. |
| ZP Shkodër | janë dërguar shkresat përkatëse drejtuar prokurorive dhe është konstatuar se disa prej tyre në cilesinë e palës kreditore nuk kanë kthyer përgjigje | do të procedohet me njoftimin e dytë shkresor | | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | - | - | - | |
| ZP Kukës | Pas kalimit të afateve të vendosura nga gjykata për vjeljen e gjobës nga përmbaruesi do të njoftohet kreditori dhe nëse brenda tre muajve nga njoftimi i dytë shkresor do të pezullohet në bazë të nenit 615/dh te K.Pr.Civile. | | | Në proces. |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë gjatë kësaj kohe ka bërë listën ku ja ka komunikuar për çdo subjekt prokurorive përkatëse. | Konfirmimi nga kreditori pasi ka dhe kërkesa të përsëritura. | Pas njoftimit të dytë shkresor brenda tre muajve do të vijohet me pezullimin e dosjes përmbarimore me nenin 615/dh të K.Pr.Civile | Në proces |
| ZP Pogradec | janë pushuar të gjitha dosjet e mbartura që përfitojnë nga amnistia me objekt gjobë penale | nuk kemi pasur probleme | | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Përmet | | nuk kemi pasur probleme | | proces |

| **Masa Nr.1.4**<br>**Vlerësimi i dosjeve përmbarimore të mbartura të paekzekutueshme për arsye objektive** | | |
|---|---|---|
| **Përshkrimi i problemit:** | Disa tituj ekzekutivë kanë humbur objektin e tyre me kalimin e kohës si rastet e dosjeve përmbarimore me objekt "takim me fëmijë" ku fëmija është bërë madhor, ose raste të tjera të tejzgjatura pa mundësi reale ekzekutimi. | |
| **Masa: 1.4.1 Verifikimi i dosjeve përmbarimore me objekt "takim me fëmijë" dhe "Kujdestari fëmije" nëse fëmija ka mbushur moshën madhore sipas Kodit të Familjes dhe dhënia e zgjidhjes ligjore.** | | |
| **Masa: 1.4.2 Kategorizimi i dosjeve përmbarimore të tjera të mbartura dhe pa objekt për vlerësim të mëtejshëm.** | | |
| **Kompetenca:** | **Institucion përgjegjës** | **Institucion kontribues** |
| | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | |
| **Burimet:** | Kryetarët<br>Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë | |
| **Koha:** | Kohëzgjatja: 2025-2030 | Faza : |

**Masa 1.4 Vlerësimi i dosjeve përmbarimore të mbartura të paekzekutueshme për arsye objektive**

**Progresi**

Gjatë periudhës raportuese, përmbaruesit gjyqësorë kanë kryer vlerësimin e dosjeve përmbarimore që nuk mund të ekzekutohen për arsye objektive, veçanërisht ato me objekt takim fëmije dhe kujdestari fëmije, sipas parashikimeve të Kodit të Familjes. Janë evidentuar dhe verifikuar të gjitha dosjet përmbarimore me objekt "takim fëmije" dhe "kujdestari fëmije", duke kontrolluar moshën e fëmijëve dhe gjendjen aktuale për ekzekutim. Për fëmijët që kanë mbushur moshën madhore, janë ndjekur procedurat përkatëse për pushimin e ekzekutimit sipas ligjit.

Për dosjet ku fëmijët nuk kishin mbushur 18 vjeç, janë kryer njoftime për paraqitjen e palëve dhe janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për vijimin e ekzekutimit. Për disa raste, pala kreditore është kallzuar penalisht për pengim të ekzekutimit pranë prokurorisë përkatëse.

Kategorizimi i dosjeve – Të gjitha dosjet përmbarimore janë kategorizuar sipas objektit të tyre dhe është vlerësuar mundësia e ekzekutimit të tyre. Dosjet pa objekt, të tjera të mbartura, janë

gjithashtu kategorizuar dhe për disa prej tyre janë marrë vendime pushimi në marrëveshje me kreditorin.
Procesi i verifikimit dhe kategorizimit është kryer për të gjitha dosjet e mbartura dhe veprimet për ekzekutimin e tyre vijojnë sipas nevojës. Aktualisht nuk ka dosje të pakategorizuara ose të paekzekutueshme për arsye objektive që nuk janë trajtuar.

**Problematikat kryesore**

- Ngarkesë e lartë pune dhe volum i madh dosjesh për çdo përmbarues.
- Mungesë bashkëpunimi dhe vonesa nga institucione si Prokuroritë, IKMT dhe ASHK.
- Adresa të paplota ose të pasakta për palët në dosjet e vjetra.
- Subjekte debitore të çregjistruara ose me status pasiv në QKB, pa pasuri të sekuestrueshme.

**Hapat në vijim**

- Përfundimi i verifikimit dhe pushimit të të gjitha dosjeve ku plotësohen kushtet ligjore (p.sh. fëmijët kanë mbushur moshën madhore).
- Kategorizimi i mbetur i dosjeve të paekzekutueshme dhe pa objekt.
- Përsëritja e kërkesave për informacion institucioneve bashkëpunuese.
- Bashkëpunim me gjendjen civile për verifikimin e datëlindjeve dhe adresave.
- Zbatim i procedurave sipas nenit 615/dh për rastet kur pala kreditore nuk kthen përgjigje brenda tre muajve nga kërkesa e dytë e përmbaruesit gjyqësor.

**Statusi**

Shumica e zyrave kanë arritur progres të konsiderueshëm dhe disa kanë përfunduar plotësisht detyrat e parashikuara, ndërsa pjesa tjetër është ende në fazë përfundimi për shkak të faktorëve objektivë dhe proceduralë.

**Masa: 1.4.1 Verifikimi i dosjeve përmbarimore me objekt "takim me fëmijë" dhe "Kujdestari fëmije" nëse fëmija ka mbushur moshën madhore sipas Kodit të Familjes dhe dhënia e zgjidhjes ligjore.**

| 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 22 Zyrat Përmbarimore | Zyra përmbarimore Durrës ka vijuar me procedurën e verifikimit të dosjeve përmbarimore me objekt takim me femijën dhe kujdestari fëmije nëse fëmija ka mbushur moshën sipas K.Familjes. | Nuk janë hasur problematika. | Po vijohet me procedurën për ti dhënë zgjidhje ligjore. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | duke bërë njoftime për paraqitje palëve | problematikë është për disa dosje të vjetra për të cilat palët nuk gjenden | do kërkojmë ndihmë nga zyrat e gjendjes civile për verifikimin e ditëlindjeve dhe moshës | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | Janë verifikuar fizikisht çështjet me objekt takim femije gjatë muajit korrik dhe fëmijët nuk e kanë mbushur | | do të verifikohen vazhdimisht dhe do të | I realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | moshen 18 vjeç. Pala kreditore është kallzuar penalisht për pengim të ekzekutimit të vendimit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër | | kryhen veprimet procedurale të rradhës | |
| ZP Elbasan | Për të gjitha çështjet me objekt Takim femije është bërë verifikimi i dosjeve të cilat fëmijët kanë mbushur moshën madhore dhe u është dhënë zgjidhje ligjore | Për të gjitha çështjet me objekt Takim femije është bërë verifikimi i dosjeve të cilat fëmijët kanë mbushur moshën madhore dhe u është dhënë zgjidhje ligjore | është vijuar me pushimin e dosjeve atje ku ka rezultuar se fëmijët kanë mbushur moshën madhore. | realizuar |
| ZP Lushnjë | Janë evidentuar dosjet me objekt takim/marrje fëmije të cilët kanë mbushur moshën madhore | | Janë pushuar dosjet ku ka rezultuar se fëmijët kanë mbushur moshën madhore | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | | Nuk kemi hasur asnjë problematikë | | përfunduar |
| ZP Korçë | Ka përfunduar procesi i verifikimit të dosjeve përmbarimore me objekt "takim femije dhe "kujdestari femije", kur femijët kanë mbushur moshën madhore dhe ju është dhënë zgjidhje ligjore. | | | I realizuar |
| ZP Sarandë | nuk kemi dosje me objekt kujdestari fëmijësh. Për objektin takim fëmije janë në ekzekutim. | | | në proces |
| ZP Gjirokastër | Është bërë evidentimi i dosjeve me objekt kujdestari fëmije dhe takim fëmije gjatë muajit ku fëmija ka mbushur moshën 18 vjec për të vazhduar më pas me procedurat përmbarimore | pjesa me e madhe e dosjeve nuk kanë adresa të plota ose ndodhen jashtë territorrit të Republikës së Shqipërisë | I jemi drejtuar gjendjes civile me qëllim gjetjen e adresës për të vijuar me njoftimin e palës kreditore. Jemi në pritje të përgjigjeve nga gjendja civile | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | Nuk kemi pasur Problematika . | Të gjitha dosjet me fëmijë madhore janë pushuar në 2024 | I realizuar 100% |
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me verifikimin e dosjeve me objekt takim fëmije, kujdestari fëmije duke seleksionuar dosjet në të cilat fëmijët tashmë janë në moshë madhore, dhe kanë vijuar me hartimin e vendimeve të pushimit sipas parashikimeve ligjore. | Ngarkesa që ka secili përmbaruesi nga volumi i punës dhe i dosjeve ka ndikuar në procesin e verifikimit të këtyre dosjeve pasi kërkojnë kohë fizike. | Do të vijohet me përfundimin e verifikimit dhe të pushimit të dosjeve me objektet 'takim femije' 'kujdestari femije'. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | I realizuar. |
| ZP Shkodër | Është bërë evidentimi i dosjeve me objekt kujdestari fëmije dhe takim fëmije gjatë ketij muaji ku fëmija ka mbushur moshen 18 vjec për të vazhduar më pas me procedurat përmbarimore | pjesa më e madhe e dosjeve nuk kanë adresa të plota ose ndodhen jashtë territorrit të Republikës së Shqipërisë | Do i drejtohemi gjendjes civile me qëllim gjetjen e adresës që të vijohet me njoftimin e palës kreditore | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Janë verifikuar fizikisht 14 çështjet me objekt takim fëmije dhe 4 çështje me objekt kujdestari femije gjatë muajit korrik dhe fëmijet nuk e kanë mbushur moshën 18 vjeç. Një kujdestari e ekzekutuar tërësisht dhe një është pezulluar me kërkesën e kreditores, dy dosje për takim u është kërkuar të paraqiten në zyrë. | | do të verifikohen vazhdimisht dhe do të kryhen veprimet procedurale të rradhës | I realizuar |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Zyra përmbarimore Krujë ka vijuar me procedurën e verifikimit të dosjeve përmbarimore me objekt takim me fëmijen dhe kujdestari fëmije nëse fëmija ka mbushur moshën sipas K.Familjes. | Nuk ka problematika. | Po vijohet me procedura standarte | Në proces |
| ZP Pogradec | nuk kemi dosje me objekt kujdestari fëmijësh. Për objektin takim fëmije gjatë këtij muaji janë evidentuar dosjet kur fëmija ka mbushur moshën 18 vjeç për të vazhduar më pas me procedurat përmbarimore | shumica e dosjeve nuk kanë adresa te plota | Do i drejtohemi gjendjes civile me qëllim gjetjen e adresës që të vijohet me njoftimin e palës kreditore | në proces |
| ZP Përmet | nuk kemi dosje me objekt kujdestari fëmijësh. Për objektin takim fëmije janë në ekzekutim. | | | në proces |

**Masa: 1.4.2 Kategorizimi i dosjeve përmbarimore të tjera të mbartura dhe pa objekt për vlerësim të mëtejshëm.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra përmbarimore Durrës ka vijuar me procedurën e verifikimit të dosjeve përmbarimore por nga ngarkesa e dosjeve kjo do të dojë pak kohë. | Ngarkesa e dosjeve të mbartura. | Në proces kategorizimi. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | janë evidentuar dosje me debitor shoqëritë shpk apo sha të cilat janë me status pasiv | problematikë është se këto shoqëri janë çregjistruara nga sistemi në QKB dhe nuk ka mundësi gjetje të pasurisë të sekuestrueshme për të përmbushur detyrimin | kërkesë për ndihmë kreditorit nëse kanë ndonjë informacion të mundshëm për realizimin e objektit | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | - | - | - | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Elbasan | janë kategorizuar të gjitha dosjet përmbarimore | mos pagimi i tarifave të aplikimit në ASHK nga pala kreditore | Po njoftohen palët kreditore që të kryej pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| ZP Lushnjë | janë kategorizuar të gjitha dosjet përmbarimore | Mungesa e bashkëpunimit nga IKMT, si dhe mos pagimi i tarifave të aplikimit në ASHK nga pala kreditore si dhe mungesë stafi për shkak të lejes vjetore | Do të përsëritet shkresa drejtuar IKMT si dhe do të njoftohen palët kreditore që të kryej pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | | Nuk kemi hasur asnjë problematikë | | përfunduar |
| ZP Korçë | Ka përfunduar kategorizimi i dosjeve te tjera të mbartura dhe pa objekt. | | | I realizuar |
| ZP Fier | Dosjet e ndryshme janë në proces trajtimi. Janë pushuar disa në marrëveshje me kreditorin | Volumi i punës | Dosjet e ndryshme janë në proces trajtimi. Janë pushuar disa në marrëveshje me kreditorin | Në proces. |
| ZP Sarandë | nuk kemi dosje me objekte të pakategorizuara. | | | Realizuar |
| ZP Gjirokastër | nuk kemi dosje me objekte të pakategorizuara | | | Realizuar |
| ZP Tropojë | Klasifikuar | Nuk kemi pasur Problematika . | Nuk ka asnjë dosje në ekzekutim | |
| Zyrat Vendore Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor janë në fazë vlerësimi dhe kategorizimi të këtyre dosjeve. | Ngarkesa që ka secili përmbaruesi nga volumi i punës dhe i dosjeve ka ndikuar në procesin e kategorizimit të këtyre dosjeve pasi kërkojnë kohë fizike. | Do të vijohet nga puna për kategorizimin e dosjeve përmbarimore të mbartura,duke marrë parasysh dhe afatet kohore të përcaktuara në këtë plan. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | |
| ZP Shkodër | nuk kemi dosje me objekte te pakategorizuara | | | Realizuar |
| Zyra Vendore Përmbarimore Kurbin | - | - | - | - |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | I realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Krujë | Zyra përmbarimore Krujë ka vijuar me procedurën e verifikimit të dosjeve përmbarimore por nga ngarkesa e dosjeve kjo do të dojë pak kohë. | Ngarkesa e dosjeve të mbartura. | Në proces kategorizimi. | Në proces |
| ZP Pogradec | nuk kemi dosje me objekte të pakategorizuara | | | Realizuar |
| ZP Përmet | nuk kemi dosje me objekte të pakategorizuara. | | | Realizuar |

<table>
<tr><td colspan="2">Masa Nr.1.5<br>Trajtimi i dosjeve përmbarimore të mbartura me objekt “detyrim në të holla” ku nuk gjendet pasuri e sekuestrueshme në emër të palës debitore dhe mungesë bashkëpunimi nga pala kreditore.</td></tr>
<tr><td>Përshkrimi i problemit:</td><td>Një numër i madh i dosjeve përmbarimore me objekt “detyrim në të holla” të mbartura qëndrojnë aktive pasi debitorët nuk kanë pasuri të identifikueshme për ekzekutimin e detyrimit. Në shumë raste, edhe kreditorët nuk bashkëpunojnë, duke mos ndjekur procedurat për regjistrimin e urdhrit të sekuestros në ASHK përmes platformës e – Albania, kundrejt tarifës përkatëse në zbatim të VKM nr. 389, datë 13.05.2020 « Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale » dhe nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu problem përbën edhe moszbatimi i urdhrave të sekuestros nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, të cilët përgjigjen se nuk janë më kompetent dhe se përmbaruesit gjyqësorë duhet t’i drejtohen RBS, e cila edhe nga kjo e fundit kërkohen tarifa për regjistrimin e urdhrit të sekuestros konservative mbi mjetet motorrike që mund të ketë pala debitore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Masa: 1.5.1 Të evidentohen të gjitha dosjet përmbarimore të mbartura me objekt “detyrim në të holla” për të cilat janë kryer veprime përmbarimore dhe nuk është gjetur pasuri e sekuestrueshme në emër të palës debitore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Masa: 1.5.2 Të përsëriten veprimet përmbarimore mbi gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme në dosjet përmbarimore të mbartura me objekt “kthim shume”</td></tr>
<tr><td colspan="2">Masa: 1.5.3 Në rast se kreditori nuk bashkëpunon për regjistrimin e urdhrit të sekuestros konservative në ASHK, kundrejt tarifave përkatëse në zbatim të VKM nr. 389, datë 13.05.2020 « Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale » dhe nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile, të vlerësoshet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Masa: 1.5.3 Në rast se pas përsëritjes së procedurave përmbarimore për kryerjen e hetimit të plotë mbi gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme të palës debitore, rezulton në mënyrë shteruese se nuk ka pasuri të sekuestrueshme, të vlerësohet pezullimi i dosjes përmbarimore në zbatim të nenit 615/d të Kodit të Procedurës Civile.</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **Kompetenca:** | **Institucion përgjegjës** | **Institucion kontribues** |
| | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | Palët kreditore, ASHK, DRSHTRR |
| **Burimet:** | Kryetarët<br>Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë | |
| **Koha:** | Kohëzgjatja: 2025-2030 | Faza : |

**Masa 1.5 – Trajtimi i dosjeve përmbarimore të mbartura me objekt "detyrim në të holla", ku nuk gjendet pasuri e sekuestrueshme në emër të palës debitore dhe mungon bashkëpunimi nga pala kreditore**

**Progresi**

Janë evidentuar të gjitha dosjet përmbarimore me objekt detyrim në të holla, ku pasuria e sekuestrueshme e debitorit nuk është gjetur dhe ka munguar bashkëpunimi nga pala kreditore. Për secilën dosje janë kryer të gjitha procedurat përmbarimore të mundshme për gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme, duke përfshirë njoftime dhe komunikime të përsëritura me palët debitore dhe kreditore, si dhe bashkëpunim me Policinë e Shtetit. Janë ripërsëritur urdhrat e sekuestros konservative për disa dosje dhe janë dërguar palëve kreditore për dijeni dhe pagesën e aplikimeve pranë DRASHK. Disa dosje kanë rezultuar me pagesa të pjesshme nga debitorët pas lokalizimit të tyre. Për dosjet ku, pas kryerjes së hetimit të plotë mbi pasuritë e debitorit, nuk është konstatuar pasuri e sekuestrueshme, është vlerësuar pezullimi i tyre në zbatim të nenit 615/d të Kodit të Procedurës Civile. Procesi i pezullimit do të kryhet rast pas rasti, pasi të ketë kaluar afati 3-mujor i njoftimit ndaj palëve kreditore dhe të administrohen përgjigjet zyrtare nga institucionet përkatëse. Masa është realizuar në masë të konsiderueshme, duke evidentuar dhe trajtuar dosjet e mbartura, duke përsëritur veprimet përmbarimore dhe duke vendosur pezullimin për dosjet pa pasuri të sekuestrueshme. Për disa dosje, veprimet vijojnë derisa të përfundojë procesi i njoftimeve dhe marrjes së përgjigjeve zyrtare.

**Problematikat kryesore**

- Mungesë bashkëpunimi nga pala kreditore, duke mos ofruar informacion mbi pasuritë e mundshme të debitorit.
- Subjekte debitore të çregjistruara ose me status pasiv në QKB, pa pasuri të sekuestrueshme.
- Mungesë bashkëpunimi nga institucionet (IKMT, ASHK) për dhënien e të dhënave të nevojshme.
- Ngarkesë e lartë pune për çdo përmbarues dhe vonesa procedurale.
- Raste të adresave të pasakta ose pamundësi gjetjeje të debitorit.

**Hapat në vijim**

- Përsëritja e kërkesave ndaj institucioneve përkatëse dhe kreditorëve për sigurimin e informacionit mbi pasuritë e debitorit.
- Zbatimi i procedurave ligjore sipas nenit 615/dh për pushimin e dosjeve kur mungon reagimi i palës kreditore.
- Evidentimi dhe dokumentimi i të gjitha përpjekjeve për gjetjen e pasurisë së debitorit.
- Koordinim i shtuar me QKB, gjendjen civile dhe institucionet financiare për verifikime të hollësishme.

**Statusi**

Një pjesë e zyrave kanë përfunduar plotësisht procesin dhe kanë mbyllur dosjet sipas procedurave ligjore. Pjesa tjetër është ende në proces për shkak të mungesës së informacionit, volumit të lartë të dosjeve dhe vonesave nga institucionet bashkëpunuese.

**Masa: 1.5.1 Të evidentohen të gjitha dosjet përmbarimore të mbartura me objekt "detyrim në të holla" për të cilat janë kryer veprime përmbarimore dhe nuk është gjetur pasuri e sekuestrueshme në emër të palës debitore.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës dosje me objekt detyrime në të holla i ka trajtuar gjatë gjithë kohës dhe që nuk i është gjetur pasuri palës debitore dhe ka munges bashkepunim nga pala kreditore. | Pala kreditore dhe pse ka mbi tre përgjigje negative nga të gjithë institucionet për mos paisje pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme nuk pranon vendimin e pezullinit por kërkon dhe kthimin e taksës përmbarimore. | Në proces trajtimin si problematika. | Në proces |
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës është në procesin e evidentimin të dosjeve me objekt detyrime në të holla dhe që i janë kryer veprime përmbarimore. | | Në proces trajtimin si problematika. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | janë evidentuar të gjitha dosjet përmbarimore me objekt kthim shume | problematikat kryesore në të shumtën e rasteve në mos ekzekutimin e këtyre dosjeve përmbarimore është mungesa e pasurive të mundshme për sekuestrim | hapat në vazhdim do të jenë kërkimi nëpërmjet sekuestrove konservative për pasuri të mundshme për sekuestrim dhe kërkesa kreditorit për ndihmë. | realizuar |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Elbasan | Janë kryer procedurat përmbarimore për gjetjen e pasurive të sekuestrueshe. Disa palë kanë bashkëpunuar duke kryer pagesën e aplikimit të ASHK-së ku ka rezultuar që nuk ka pasuri të sekuestrueshme | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-se nga një pjesë e kreditorëve si dhe mos vendosja e sekuestros nga DRSHTR-ja | Do të rinjoftohen palët kreditore që të kryej pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh. Për palët të cilat nuk ka pasuri të sekuestrueshme është vijuar me pushimin e tyre sipas neni 615/d | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë kryer procedurat përmbarimore për gjetjen e pasurive të sekuestrueshme. Disa palë kanë bashkëpunuar duke kryer pagesën e aplikimit të ASHK-së ku ka rezultuar që nuk ka pasuri të sekuestrueshme | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-se nga një pjesë e kreditorëve si dhe mos vendosja e sekuestros nga DRSHTR-ja | Do të rinjoftohen palët kreditore që të kryej pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh. Për palët të cilat nuk ka pasuri të sekuestrueshme është vijuar me pushimin e tyre sipas neni 615/d. Për palët që rezultojnë me pasuri do të vijohet në gjykatë me veçimin e pjesëve takuese pasi rezultojnë bashkëpronarë | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | Janë evidentuar dosjet përmbarimore të mbartura me objekt "detyrim në të holla" për të cilat janë kryer veprime përmbarimore dhe nuk është gjetur pasuri e sekuestrueshme në emër të debitorit | Nuk kemi hasur asnjë problematikë | | përfunduar |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100% prej muajit gusht 2025. | Nuk kemi hasur asnjë problematikë. | | I realizuar |
| ZP Fier | Do ripërsëriten dhe njëhere sekuestrot. | Volumi i punës | Disa nga dosjet kanë qënë të mbartura shumë herët.Mund të pezullohen dhe me kërkesën e debitorit. | Në proces. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Sarandë | janë evidentuar të gjitha dosjet e mbartura me këtë objekt | | do përseriten urdhër sekuestro për kerkim informacioni për gjetjen e pasurive te sekuestrueshme duke i kërkuar palës kreditore. | në proces |
| ZP Gjirokastër | janë evidentuar të gjitha dosjet e mbartura me këtë objekt | një pjesë e dosjeve nuk e kanë informacionin e plotë | Janë përsëritur urdhër për vënie sekuestro konservative për të bërë të mundur informacionin për gjetjen e pasurive të sekuestrueshme | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | Nuk kemi pasur Problematika . | Nuk kemi dosje në ekzekutim me këtë objekt. | I realizuar |
| Zyra Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me evidentimin e dosjeve të mbartura me objekt 'detyrim në të holla' duke seleksionuar këto dosje dhe vijuar nga puna. Janë ridërguar urdhërat e sekuestros konservative për disa dosje dhe jemi në fazën e administrimit të përgjigjeve ndërsa për pjesën tjetër janë bërë kërkesat ndaj palëve kreditore sipas orientimit të DPP | Ngarkesa e përmbaruesve gjyqësor për shkak të numrit të lartë të dosjeve që ka në ngarkim secili përmbarues gjyqësor si dhe problematikat me dërgimin e akteve përmbarimore për shkak të adresave të mangëta apo problematikave me gjetjen e adresave të debiorëve. Problematikë tjetër është edhe mungesa e bashkëpunimit të ASHK dhe DPSHTRR për zbatimin e urdhërave tonë të sekuestros konservative | Do të përfundohet procesi i evidentimit të këtyre dosjeve duke marrë parasysh dhe afatet kohore të përcaktuara në këtë plan. | Në proces |
| ZP Dibër | Janë përsëritur veprimet përmbarimore mbi gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme në dosjet përmbarimore të mbartura me objekt kthim shume për të gjetur pasuri të sekuestrueshme. | | Nga ana e debitorit ka filluar shlyerja me këste e detyrimit ndaj kreditorit. | Në proces. |
| ZP Shkodër | janë evidentuar të gjitha dosjet e mbartura me këte objekt | një pjesë e dosjeve nuk kanë informacionin e plotë | do përsëriten urdhër për vënie sekuestro konservative për të bërë të mundur informacionin për gjetjen e pasurive të sekuestrueshme | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Për këtë kategori kemi evidentuar dhe ripërsëritur urdhrat e sekuestros, të cilat i kemi përcjellë edhe palëve kreditore për dijeni dhe për kryerjen e pagesës së aplikimit pranë DRASHK Lezhë. | ka mungesë të përgjigjeve të DRASHK-se për të cilin kemi bërë aplikimin dhe u kemi përcjellë kreditorëve mandatin e arkëtimit për likujdim për të marrë shërbimin në DRASHK | do të mbetemi në pritje të likujidmit të faturës së aplikimit për të proceduar më tej | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | 2 dosje, të kësaj kategorie të evidentuara | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë dosje me objekt detyrime në të holla i ka trajtuar gjatë gjithë kohës dhe që nuk i është gjetura pasuri palës debitore dhe ka munges bashkepunim nga pala kreditore | Debitorët nuk kanë pasuri të identifikueshme për ekzekutimin e detyrimit..Debitorët nuk bashkëpunojnë, duke mos ndjekur procedura për regjistrimin e urdhrit të sekuestros në ASHK përmes platformës e - Albania, kundrejt tarifës | Në proces trajtimin si problematika. | Në proces |
| ZP Pogradec | janë evidentuar të gjitha dosjet e mbartura me këtë objekt | një pjesë e dosjeve nuk e kanë informacionin e plotë | do përseriten urdhër sekuestro për kërkim informacioni për gjetjen e pasurive të sekuestrueshme duke i kërkuar palës kreditore pagimin e shpenzimeve | në proces |
| ZP Përmet | janë evidentuar të gjitha dosjet e mbartura me këtë objekt | | do përseriten urdhër sekuestro për kërkim informacioni për gjetjen e pasurive të sekuestrueshme duke i kërkuar palës kreditore. | në proces |

**Masa: 1.5.2 Të përsëriten veprimet përmbarimore mbi gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme në dosjet përmbarimore të mbartura me objekt "kthim shume"**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës është në procesin e evidentimit të dosjeve me objekt detyrime në të holla dhe që i janë kryer veprime përmbarimore. | Jan përsëritur deri në dy sekuestro ne dosjet përmbarimore të mbartura me objekte kthime shume. | Në proces trajtimin si problematika. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | janë përsëritur të gjitha veprimet përmbarimore për gjetjen e pasurive të mundshme për sekuestrim dhe për disa dosje përmbarimore kemi vendosur sekuestro ekzekutive në pagë. | për shumë dosje përmbarimore me objekt kthim shume nuk kemi pasuri të mundshme për sekuestrim | hapat ne vazhdim do të jenë kërkimi nëpërmjet sekuestrove konservative për pasuri të mundshme për sekuestrim dhe kërkesa kreditorit për ndihmë. | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Pukë | | | | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Elbasan | Janë kryer procedurat përmbarimore për gjetjen e pasurive të sekuestruestrueshme | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-se nga një pjesë e kreditorëve si dhe mos vendosja e sekuestros nga DRSHTR-ja | Janë rinjoftuar palët kreditore që të kryejne pagesat e aplikimit në ASHK dhe rispërseritje të sekuestrove në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë kryer procedurat përmbarimore për gjetjen e pasurive të sekuestrueshme | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-se nga një pjesë e kreditorëve si dhe mos vendosja e sekuestros nga DRSHTR-ja | Do të rinjoftohen palët kreditore që të kryej pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh. Për palët të cilat nuk ka pauri të sekuestrueshme është vijuar me pushimin e tyre sipas nenit 615/d. | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | | | | përfunduar |
| ZP Korçë | Përgjatë muajit dhjetor janë trajtuar me përparësi dosjet e mbartura me mundësi reale ekzekutimi, duke pasur parasysh që muaji dhjetor përbën përiudhën përmbyllese të vitit. Janë kryer njoftime dhe komunikime të përsëritura me palët debitore, falë edhe bashkëpunimit të intesifikuar me Policinë e Shtetit, të cilët kanë mundësuar lokalizimin e debitorëve, duke u likujduar detyrimi nga ana e tyre. Falë këtij procesi është bërë e mundur vjelja e detyrimit për njësërë dosjesh përmbarimore. | Mungesë bashkëpunimi nga pala kreditore për aplikimet në ASHK. Një pjesë e kreditoreve/debitorëve nuk gjenden në adresat e deklaruara, çka e bën të pamundur kryerjen e veprimeve të mëtejshme përmbarimore apo njoftimin e tyre. | Do të intesifikohet bashkëpunimi me instuticionet shtetërore dhe subjektet private, për sigurimin e informaioneve të nevojshme mbi pasuritë e debitorit. Për një sërë dosjesh përmbarimore do të vlerësohet pezullimi bazuar në nenin 615/dh të Kodit të Procedurës Civile. | Në proces |
| ZP Fier | Janë realizuar disa por jo të gjitha. | Volumi i punës | Do rishikohet dhe pezullimi në bashkëpunim me kreditorin pasi të bëhet hetimi shterues. | Në proces. |
| ZP Sarandë | janë evidentuar dosjet e mbartura me objekt detyrim në të holla për të parë ripërsëritjen e veprimeve | palë kreditore nuk është interesuar për një kohë te gjatë | do ripërsëriten veprimet dhe do njoftohen palët me qëllim gjetjen e pasurisë | në proces |
| ZP Gjirokastër | janë evidentuar dosjet e mbartura me objekt detyrim në të holla për të parë ripërsëritjen e veprimeve | pala kreditore nuk është interesuar për një kohë të gjatë | janë ripërsëritur veprimet dhe do njoftohen palët me qëllim gjetjen e pasurisë | në proces |
| ZP Tropojë | | Nuk kemi pasur Problematika . | veprime të përsëritura në 2025 | Në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyrat Vendore Përmbarimore Tiranë | Pëmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me përsëritjen e sekuestrove për dosjet e mbartura me objekt 'Kthim shume'. | Problematika e hasur në këto dosje është volumi dhe ngarkesa e madhe në punë si dhe mungesa e informacionit nga ana e ASHK kryesisht, për shkak të aplikimit të tarifave si dhe mungesa e adresave të sakta të palëve kreditore për vijimin e procedurës. | Do të vijohet nga procedura për realizimin tërësisht të këtij plani, në rastet kur mungon adresa e saktë e palës kreditore do të vijohet me kërkesa për saktësim adrese. | Në proces |
| ZP Dibër | Janë përsëritur veprimet përmbarimore mbi gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme në dosjet përmbarimore të mbartura me objekt kthim shume . | | Arsyet për mosekzekutimin të dosjeve përmbarimore të mbartura janë pasi nuk kanë pasuri të regjstruar në emër të tyre. | Në proces. |
| ZP Shkodër | janë evidentuar dosjet e mbartura me objekt detyrim në të holla për të parë ripërsëritjen e veprimeve | palë kreditore nuk është interesuar për një kohë të gjatë | do ripërsëriten veprimet dhe do njoftohen palët me qëllim gjetjen e pasurisë | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Për këtë kategori kemi evidentuar dhe ripërsëritur urdhrat e sekuestros, të cilat i kemi përcjellë edhe palëve kreditore për dijeni dhe për kryerjen e pagesës së aplikimit pranë DRASHK Lezhë. | ka mungesë të përgjigjeve të DRASHK-së për të cilin kemi bërë aplikimin dhe u kemi përcjellë kreditoreve mandatin e arkëtimit për likujdim për të marrë shërbimin në DRASHK | do të mbetemi në pritje të likujidmit të faturës së aplikimit për të proceduar më tej | në proces |
| ZP Kukës | Janë përsëritur veprimet përmbarimore mbi gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme në dosjet përmbarimore të mbartura me objekt kthim shume . | | Jemi në pritje të përgjigjeve nga institucionet zyrtare. | Në proces. |
| ZP Mat | 2 dosje, me veprime të përsëritura | | | i realizuar |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë është në proces evidentimi të dosjeve me objekt detyrime në të holla dhe që janë kryer veprime përmbarimore. | Jan përsëritur sekuestro në dosjet përmbarimore të mbartura me objekte kthime shume. | Në proces trajtimin si problematika. | Në proces |
| ZP Pogradec | janë evidentuar dosjet e mbarura me objekt detyrim në të holla për të parë ripërsëritjen e veprimeve | palë kreditore nuk është interesuar për një kohë të gjatë | do ripërsëriten veprimet dhe do njoftohen palët me qëllim gjetjen e pasurisë | në proces |
| ZP Përmet | janë evidentuar dosjet e mbarura me objekt detyrim në të holla për të pare ripërseritjen e veprimeve | palë kreditore nuk është interesuar për një kohë të gjatë | do ripërsëriten veprimet dhe do njoftohen palët me qëllim gjetjen e pasurisë | në proces |

**Masa: 1.5.3 Në rast se kreditori nuk bashkëpunon për regjistrimin e urdhrit të sekuestros konservative në ASHK, kundrejt tarifave përkatëse në zbatim të VKM nr. 389, datë 13.05.2020 *« Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale »* dhe nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile, të vlerësoshet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra përbarimore Durrës nuk ka raste ende të evidentuara që pala kreditore nuk pranon për regjistrimin e sekuestros konservative ne ASHK, kundrejt tarifave përkatëse në zbatim të VKM nr. 389, datë 13.05.2020 « Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale » | | Do të bëjë zbatimin e nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile dhe të vlerësoshet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | Kemi bërë kërkesë palës kreditore për regjistrimin e urdhrit të sekuestros konservative ne ASHK nëpërmjet e-Albania për dosje kontraktuale private me objekt kthim shume | Pala kreditore ka bërë regjistrim në e-Albania dhe ASHK ka kthyer përgjigje | nuk ka pasuri të paluajtshme në pronësi | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | Janë njoftuar palët për përgjegjësinë ligjore për pagesën e tarifës së ASHK dhe kemi në proces njoftimin e dytë për palët që nuk janë përgjigjur njoftimit të parë nga ana e Z.P.Pukë. | | | në proces |
| ZP Elbasan | Janë evidentuar dosjet për të cilat duhet të kryet aplikimi nëse debitorët kanë pasuri të paluajtshme | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-së nga një pjesë e kreditorëve | Janë njoftuar palët kreditore që të kryejnë pagesat e aplikimit në ASHK; në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë evidentuar dosjet për të cilat duhet të kryet aplikimi nëse debitorët kanë pasuri të paluajtshme | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-se nga një pjesë e kreditorëve | Do të rinjoftohen palët kreditore që të kryejnë pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh. Për palët të cilat nuk kanë pauri të sekuestrueshme është vijuar me pushimin e tyre sipas nenit 615/d. | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | | nuk kemi hasur probleme | | përfunduar |
| ZP Korçë | | | Do të veprohet sipas udhezimit 1.5.3 të Planit të Punës. | Në proces |
| ZP Fier | | Volumi i punës | Dosjet me palë do ezaurohet në mënyrë shteruese aplikimi në ASHK.Për dosjet me Prokurorinë do veprojmë pasi të jenë njoftuar përsëri palët. | Në proces. |
| ZP Sarandë | gjatë muajit korrik janë evidentuar dosjet për tiu dërguar kreditoreve me shkresë pagimin e shpenzimeve me qëllim shterimin e kërkesave për pasuri | në një pjesë të dosjeve kemi mungesë bashkëpunimi nga kreditori | nëse pala kreditore nuk bashkëpunon paguan shpenzimet do procedohet 615/dh | në proces |
| ZP Gjirokastër | gjatë muajit janë evidentuar dosjet për tiu dërguar kreditorëve me shkresë pagimin e shpenzimeve me qëllim shterimin e kërkesave për pasuri | në një pjesë të dosjeve kemi mungesë bashkëpunimi nga kreditori | nëse pala kreditore nuk bashkëpunon, nuk paguan shpenzimet, do procedohet 615/dh | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | Nuk kemi pasur Problematika . | Kreditorët janë njoftuar ne 2025 | Në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | Aktualisht jemi në fazën e pritjes së të gjitha përgjigjeve zyrtare nga institucionet përkatëse. | Problematika e hasur në këto dosje është fillimisht mungesa e adresave të sakta për njoftimin e palëve kreditore, së dyti pezullimi i dosjes përmbarimore sipas nenit 615/dh do rishikohet me kujdes nga secili përmbarues rast pas rasti për të qënë brënda kuadrit ligjor. | Do të vijohet nga procedura për realizimin tërësisht të këtij plani, në rastet kur mungon adresa e saktë e palës kreditore do të vijohet me kërkesa për saktësim adrese. Gjithashtu do të vlerësohet rast pas rasti nëse jemi në kushtet e pezullimit të dosjes përmbarimore apo jo. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | |
| ZP Shkodër | Janë evidentuar dosjet për tiu dërguar kreditorëve me shkresë pagimin e shpenzimeve me qëllim shterimin e kërkesave për pasuri | në një pjesë të dosjeve kemi mungesë bashkëpunimi nga kreditori | nëse pala kreditore nuk bashkëpunon, nuk paguan shpenzimet do procedohet 615/dh | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Pas aplikimit të bërë, do të presim për depozitimin e mandatit nga ASHK, dhe nëse pala kreditore nuk kryen këtë veprim, do të procedohet me pezullim sipas parashikimeve të dispozitës së nenit 615/dh të KPrC. | | | në proces |
| ZP Kukës | Është dërguar shkresë me lëndë Njoftim mbi pagesën e tarifës së ASHK-së Kukës dhe Has. | | Jemi në pritje të përgjigjeve nga institucionet zyrtare. Një pjesë e tyre është paguar tarifa dhe është konfirmuar përgjigje nga ashk – Kukës që nuk kanë pasuri, me kreditor BKT - Tiranë. | Në proces |
| ZP Mat | 2 dosje, dërguar dy njoftime për pagese ASHK | | pas kalimit te afatit do pezullohen. Në proces | në proces |
| ZP Krujë | Zyra pembarimore Krujë ka raste ende te videntuara që pala kreditore nuk pranon për regjistrimin e sekuestros konservative ne ASHK, kundrejt tarifave përkatëse në zbatim të VKM nr. 389, datë 13.05.2020 « Për miratimin e listës dhe tarifave të shërbimeve kadastrale » | Nuk dakordësojnë tarifat e ASHK | Do të bëje zbatimin e nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile dhe të vlerësoshet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile. | Në proces |
| ZP Pogradec | gjatë muajit nëntor janë evidentuar dosjet për tiu dërguar kreditoreve me shkresë pagimin e shpenzimeve me qëllim shterimin kërkesave për pasuri | në një pjesë të dosjeve kemi mungesë bashkëpunimi nga kreditori që edhe pse kanë dijeni nuk paguajnë për shërbim në ASHK | nëse pala kreditore nuk bashkëpunon, nuk paguan shpenzimet, do procedohet 615/dh | në proces |
| ZP Përmet | gjatë muajit korrik janë evidentuar dosjet për tiu dërguar kreditorëve me shkresë pagimin e shpenzimeve me qëllim shterimin e kërkesave për pasuri | në një pjesë të dosjeve kemi mungesë bashkëpunimi nga kreditori | nëse pala kreditore nuk bashkëpunon paguan shpenzimet do procedohet 615/dh | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës gjatë procesite te evidentimin te dosje me objekt detyrime në të holl dhe procedurave përmbarimore te një hetimi të plotë mbi gjendej e pasurisë se sekuestrueshme te palës debitore dhe rezultateve negative do të vlerësoj pezullimin e tyre në zbatim të nenit 615/d te K.Pr.Civile. | | Do vijoj me procedurën e evidentimit të dosjeve gjatë gjithë kohës dhe për dosje që hetimin është shterues dhe negativ si përgjigje për pasuri ndaj palës debitore do të vijohet me pezullimin në zbatim të nenit 615/d K.Pr.Civile. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | për muajin Dhjetor kemi proceduar me pezullim sipas nenit 615/d te K.Pr.C | kemi proceduar me vendim pezullimi për disa dosje me objekt shpenzime proceduriale | do presim në vijim për të gjitha përgjigjet e institucioneve për dosjet e tjera | në proces |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | Nëse rezulton në mënyrë shteruese nga përgjigjet e administruara se nuk ka pasuri të sekuestrueshme për këto dosje do të vlerësohet pezullimi i dosjes përmbarimore në zbatim të nenit 615/d të Kodit të Procedurës Civile | | | në proces |
| ZP Elbasan | Janë në procese evidentimi dosjet të cilat nuk kanë pasuri të sekuestrueshme. Për një pjesë të dosjeve për të cilat janë kryer të gjitha proçedurat përmbariore dhe nuk është gjetur pasuri e sekuestrueshme është vendosur pezullimi i tyre sipas nenit 615/d | Mos vendosja e sekuestros nga ASHK-ja dhe DRSHTR | Do të njoftohen palët kreditore që të kryej pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë në procese evidentimi dosjet të cilat nuk kanë pasuri të sekuestrueshme. Për një pjesë të dosjeve për të cilat janë kryer të gjitha proçedurat përmbarimore dhe nuk është gjetur pasuri e sekuestrueshme është vendosur pezullimi i tyre sipas nenit 615/d | Mos vendosja e sekuestros nga ASHK-ja dhe DRSHTR | Do të njoftohen palët kreditore që të kryej pagesat e aplikimit në ASHK në rast mos reagimit të palës kreditore do të vijohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | | ngelet problem përgjigjet e DRSHTRR | | përfunduar |
| ZP Korçë | Pas kryerjes se njësërë procedurash përmbarimore për hetimin dhe rihetimin e plotë të pasurive të palës debitore,meqënëse nuk është konstatuar asnjë pasuri e sekuestrueshme, nga ana jonë është vijuar me pezullim të dosjes përmbarimore në zbatim të nenit 615/d të Kodit të Procedures Civile. | | Në vazhdim do të vlerësohen dosjet përmbarimore, dhe në rast se nuk do të rezultojnë pasuri të sekuestrueshme në emër të debitorit do të vijohet me pezullim në bazë të nenit 615/d të K.Pr.Civile. | Në proces |
| ZP Fier | Është aplikuar vetëm për dosjet me palë. | Volumi i punës | Do vijojë hetimi në mënyrë shteruese. | Në proces. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Sarandë | do precedohet nëse ka kaluar afati 3 mujor i njoftimit | nuk është plotësuar afati 3 mujor | | në proces |
| ZP Gjirokastër | me kalimin e afatit 3 mujor të njoftimit | është vijuar me njoftimin e dytë shkresor, në pritje të kalimit të afatit | | në proces |
| ZP Tropojë | Në proces | Nuk kemi pasur Problematika . | Verfikime të kryera në 2025, dosje në vlerësim e sipër për pezullim. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Tiranë | Aktualisht jemi në fazën e pritjes së të gjitha përgjigjeve zyrtare nga institucionet përkatëse. | Problemi kryesor për pezullimin e këtyre dosjeve është mungesa e informacionit nga ASHK nëse ka ose jo pasuri, më tej të kërkohet aplikimi për vendosjen e sekuestros konservative, por duke qënë se na mungon informacioni fillestar, kjo sjell zvarritjen e procedurave përmbarimore. | Me VKM e re që doli duhet të orientohemi se si te përdorim apo aplikojmë si institucion shtetëror me tarifë të reduktuar edhe pse në ketë rast duhet që tarifa të parapaguhet dhe zyrat tona nuk kanë zë të veçant në buxhet për këto lloj shpenzimesh. Sugjerojmë se një marrëveshje ndërinstitucionale me ASHK do të ishte një zgjidhje për përshpejtimin e procedurave dhe heqjen e dosjeve të mbartura. Të veprohet si në rastin e DPSHTRR e cila megjithëse nuk vijon me sekuestron, të informoj në rast se debitori ka pasuri dhe në këtë mënyrë mund të informohemi mbi pasuritë dhe me pas të vlerësojmë me palët kreditore nëse është i interesuar për të proceduar me sekuestron me aplikim . | Në proces |
| ZP Dibër | | | Pas përsëritjes së veprimeve përmbarimore mbi kryerjen e hetimit të plotë mbi gjetjen e pasurisë së sekuestrueshme të palës debitore dhe rezulton se në menyrë shteruese nuk ka pasuri të sekuestrueshme do të vendoset pezullimi i dosjes përmbarimore sipas nenit 615/d të K.Pr.Civile. | Në proces. |
| ZP Shkodër | do precedohet nëse ka kaluar afati 3 mujor i njoftimit | nuk është plotësuar afati 3 mujor | me përmbushjen e afatit do dilet me vendim | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Nëse rezulton në mënyrë shteruese nga përgjigjet e administruara se nuk ka pasuri të sekuestrueshme për këto dosje do të vlerësohet pezullimi i dosjes përmbarimore në zbatim të nenit 615/d të Kodit të Procedurës Civile | | | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | janë njoftuar kreditorë me dy njoftime | | pas kalimit të afatit do pezullohen | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë gjatë procesit të evidentimit të dosjeve me objekt detyrime në të holla dhe procedurave përmbarimore të një hetimi të plotë mbi gjendjen e pasurisë së sekuestrueshme të palës debitore dhe rezultateve negative do të vlerësoj pezullimin e tyre në zbatim të nenit 615/d të K.Pr.Civile. | | Do vijoj me procedurën e evidentimit të dosjeve gjatë gjithë kohës dhe për dosje që hetimi është shterues dhe negativ si përgjigje për pasuri ndaj palës debitore do të vijohet me pezullimin në zbatim të nenit 615/d K.Pr.civile. | Në proces |
| ZP Pogradec | do precedohet nëse ka kaluar afati 6 mujor i njoftimit | nuk është plotësuar afati 6 mujor dhe nëse nuk ka krijuar pasuri të luajtshme/të paluajtshme | | në proces |
| ZP Përmet | do precedohet nëse ka kaluar afati 3 mujor i njoftimit | nuk është plotësuar afati 3 mujor | | në proces |

| | | |
|---|---|---|
| **Masa Nr.1.6**<br>**Trajtimi i dosjeve përmbarimore të mbartura me objekt "lirim, dorëzim sendi" ku mungon mbështetja institucionale e IKMT** | | |
| **Përshkrimi i problemit:** | Shumë dosje përmbarimore me objekt "lirim, dorëzim sendi" qëndrojnë të mbartura për shkak të mosbashkëpunimit nga IKMT për ofrimin e mbështetjes logjistike dhe mungesës së parapagimit të shpenzimeve përmbarimore nga kreditorët. Këto shpenzime lidhen me përfshirjen e mjeteve si fadroma, fuqi punëtore, ekspërt topograf etj. | |
| **Masa: 1.6.1 Të evidentohen dosjet përmbarimore të mbartura me objekt "lirim dorëzim sendi".** | | |
| **Masa: 1.6.2 Të ripërsëriten kërkesat për mbështetje në ekzekutim nga IMT sipas nenit 523 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 42 të Ligjit nr. 8/2023.** | | |
| **Masa: 1.6.3 Të njoftohet pala kreditore mbi nevojën e parapagimit të shpenzimeve përmbarimore në bazë të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile.** | | |
| **Masa: 1.6.4 Në rast se kreditori nuk përgjigjet sipas masës 1.6.3, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësoshet pezullimi i ekzekutimit sipas nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.** | | |
| **Masa:1.6.5 Të kërkohet zyrtarisht bashkëpunimi i IKMT nëpërmjet një marrëveshje bashkëpunimi me DPP.** | | |
| **Kompetenca:** | **Institucion përgjegjës** | **Institucion kontribues** |
| | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore për masat 1.6.1 – 1.6.4 | DPP |

| | | |
|---|---|---|
| **Burimet:** | Kryetarët<br>Përmbaruesit Gjyqësor<br>Shtetërorë | |
| Koha: | Kohëzgjatja: 2025-2030 | Faza : |

**Masa 1.6 – Trajtimi i dosjeve përmbarimore të mbartura me objekt "lirim, dorëzim sendi" ku mungon mbështetja institucionale e IKMT**

**Progresi**

Janë evidentuar dosjet përmbarimore me objekt "lirim dhe dorëzim sendi". Zyra Përmbarimore Durrës ka evidentuar 3–4 dosje të mbartura; Zyra Krujë ka 1 dosje; Zyrat e tjera (Elbasan, Vlorë, Korçë) nuk kanë dosje aktive me këtë problematikë. Për të gjitha dosjet e evidentuara, përmbaruesit gjyqësor kanë kryer hartimin dhe kontrollin e dokumentacionit të nevojshëm. Për dosjet ku është e nevojshme mbështetja institucionale e IKMT, janë përsëritur kërkesat për mbështetje çdo 6 muaj. Në disa raste, pala kreditore ka kërkuar që ekzekutimi të kryhet nga zyra përmbarimore me ndihmën e IKMT, për shkak të pamundësisë për të siguruar mjete për prishje apo lirimin e sendit. Përmbaruesit kanë njoftuar palët kreditore mbi nevojën për parapagimin e shpenzimeve në zbatim të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile. Palët kreditore janë përgjigjur menjëherë për kryerjen e parapagimit të shpenzimeve përmbarimore. Masa është realizuar në mënyrë të plotë për dosjet ekzistuese: të gjitha janë evidentuar, janë përsëritur kërkesat për mbështetje nga IKMT dhe palët kreditore janë njoftuar për parapagimet. Aktualisht, nuk ka dosje të tjera aktive me objekt "lirim/dorëzim sendi" ku mungon mbështetja nga IKMT. Një pjesë e dosjeve janë ekzekutuar plotësisht. Në disa zyra nuk ka fare dosje me këtë objekt, ndërsa në disa të tjera procesi është ende në zhvillim për shkak të ngarkesës së madhe të punës dhe procedurave që kërkojnë koordinim ndërinstitucional.

**Problematikat kryesore**

- Mungesa e bashkëpunimit nga IKMT dhe vonesat në përgjigje, pavarësisht përsëritjes së kërkesave.
- IMT e bashkive në disa raste nuk kanë mjete në dispozicion për të realizuar ekzekutimin.
- Pamundësi ekonomike e kreditorëve për të përballuar parapagimin e shpenzimeve përmbarimore.
- Ngarkesa e lartë e përmbaruesve dhe volum i madh dosjesh, duke shkaktuar vonesa.

**Hapat në vijim**

- Intensifikimi i kërkesave zyrtare ndaj IKMT dhe organeve kompetente për mbështetje në ekzekutim.
- Zbatimi i procedurave të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile për njoftimin e kreditorëve mbi parapagimin e shpenzimeve.
- Në rast mospërgjigjeje të kreditorit brenda afatit ligjor, vlerësimi i pezullimit të ekzekutimit sipas nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.

- Përsëritja e kërkesave ndaj IMT/IKMT dhe dokumentimi i të gjitha përpjekjeve për mbështetje institucionale.
- Rishikimi i të gjitha dosjeve të mbartura për të përcaktuar mundësinë e vijimit ose mbylljes.

**Statusi aktual**
Një numër i konsiderueshëm dosjesh janë ekzekutuar ose mbyllur sipas procedurave ligjore. Pjesa tjetër është ende në proces për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga IKMT, vonesave të institucioneve vendore ose çështjeve të ndërlikuara ligjore.

**Masa: 1.6.1 Të evidentohen dosjet përmbarimore të mbartura me objekt "lirim dorëzim sendi".**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës ka pasur priorite dosje me objekt lirim dhe dorzim sendi që kërkohet mbështëtja e IKMT. | Problematika e ketyre dosjeve dihet që është mos pasja e mundeis financiare e palës kreditore.Gjithashtu, në disa raste konstatohet mungesë mbështetjeje nga strukturat e IKMT-së për shkak të ngarkesave të tyre opëracionale, duke bërë që këto dosje të mbeten pezull për një përiudhë të pacaktuar kohore. Si pasojë, zvarritja e ekzekutimit cenon efektivitetin e vendimeve gjyqësore dhe krijon problematika në përmbushjen e afateve ligjore të ekzekutimit. | Zyra Përmbarimore do të intensifikojë kërkesat zyrtare për asistencë pranë IKMT-së dhe organeve të tjera kompetente, duke kërkuar përcaktimin e datës së ndërhyrjes. Paralelisht, të aplikohen masat ligjore ndëshkuese ndaj debitorit që pengon ekzekutimin, si dhe të kërkohet vendim shtesë nga gjykata kur procedura pengohet në mënyrë të vazhdueshme. | Proces |
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës është ne procedur për evidentimin te ketyre dosjeve duke pare dhe ndarkesen e dosjeve te mbarura. | | Po bëhet evidentimi dhe njëkohëshisht dhe kërkesat për mbështëtje. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | janë evidentuar të gjitha dosjet përmbarimore me objekt "lirim dhe dorëzim sendi" | problematikat e ketij objekti për një dosje përmbarimore është se pala debitore është I ndaluar ne burg dhe nuk mund te jete I pranishem në ekzekutim pasi nga banesa do largojme sendet përsonale ,dosjet e tjera përmbarimore janë në proces | për rastin e debitorit që është ne burg do bejm procedurën e inventarizimit te pasurive te luajtshme dhe kërkesë përgjetjen e një ekspërti | në proces |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | | | | nuk ka dosjor |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Elbasan | Janë evidentuar dosjet me objekt lirim dhe dorzim sendi | Janë evidentuar dosjet me objekt lirim dhe dorzim sendi ku ka dosje që debitorët te ndodhen jashte shteti sipas konfirmimit te Komisariateve respektive | Janë evidentuar dosjet me objekt lirim dhe dorzim sendi ku ka dosje që ehte vazhduar me procedure për shpallje dhe me pas për emerim emerim përfaqësuesi ligjor neni 522 K.Pr.Civile | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë evidentuar dosjet me objekt lirim dhe dorzim sendi | IKMT nuk bashkëpunon ndërsa IMTV e Bashkive bashkëpunojnë por ka raste që nuk kanë mjete ndaj kërkohet bashkëpunimi I IKMT-së | Do vijohet të dergohen shkresa IKMT-se për mbështetje | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | ngelen 4 dosje për të cilat kërkohet mbështetja me mjete nga IKMT | | | përfunduar |
| ZP Korçë | Pranë Zyrës Përmbarimore Korçë nuk kemi asnjë dosje në proces ekzekutimi me objekt ‘’lirim dorëzim sendi’’. | | | I realizuar |
| ZP Fier | | | | 100% |
| ZP Sarandë | zyra ka te regjistruar një dosje me objekt Lirim Dorëzim Sendi | Kreditori është larguar jashte shtetit | | |
| ZP Gjirokastër | është bërë evidentimi I dosjeve të mbartura me objekt lirim dorëzim sendi | mungesë mbështëtje nga institucionet ku vlen te përmendim Policinë e Shtetit në mënyrë te përsëritur duke mos ofruar mbështëtje në ekzekutim ne datën ,oren dhe vendin e ekezekutimit ,mungesa e aftesise paguese te shpenzimeve gjatë fazes se ekzekutimit si psh: pagimi i tarifes se ekspërtit | është vijuar me dërgimin e shkresave për realizimin tereisht t e titullit ekzekutiv | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | | Nuk ka asnjë dosje në ekzekutim | |
| ZP Tiranë | Nga ana e përmbaruesve gjyqësor është kryer evidentimi i dosjeve përmbarimore të mbartura me objekt 'lirim dorëzim sendi'. | Ngarkesa që ka secili përmbaruesi nga volumi i punës dhe i dosjeve ka ndikuar në procesin e vlerësimit të këtyre dosjeve pasi kërkojnë kohë fizike. | Nëse ka dosje të pa evidentuara do të merren masa për evidentimin dhe fillimin e procedurave përkatëse. | Në proces |
| ZP Dibër | Në Zyrën Përmbarimore kemi të mbartura çështje me objekt lirim dorëzim sendi. | | | |
| ZP Shkodër | është bërë evidentimi I 3 dosjeve të mbartura me objekt lirim dorëzim sendi | Janë caktuar datat për ekzekutimin e vendimit me kërkesë Policisë dhe Bashkise. | vijohet me procedurën | në proces |
| Zyra Vendore Përmbarimore Kurbin | janë evidentuar nga ana jone dhe kemi vetëm 1 çështje | nuk na është siguruar mbështëtja nga IMT dhe IKMT sipas nenit 523 te K.Pr.C që e ngarkon kete institucion me detyrimin që të na mbështëse gjatë ekzekutimit. | IKMt Nuk ka mundesi për shkak te axhendes se ssaj ndërsa IMT Kurbin nuk disponon mjete ne dispozicion për prishjen. | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje te kësaj kategore | | | |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë ka vetëm një dosje me objekt lirim dhe dorzim sendi | Nga ana e kreditorit është njoftuar të mos vijohen me tej procedurat | Po bëhet evidentimi dhe njëkohëshisht dhe kërkesat për mbështëtje. | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Pogradec | zyra nuk ka te rregjistruar dosje me objekt lirim dorëzim sendi | | | |
| ZP Përmet | zyra ka te regjistruar një dosje me objekt Lirim Dorëzim Sendi | Kreditori është larguar jashte shtetit | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra përmbarimore Durrës në dosje që janë evidentuar ke vijaur dhe me kërkesat për mbështëtje I.M.T | Për shkak te ngarkesave këto organe nuk përcaktojne një datë fikse për të na mbështëture në ekzekutimin teresishte te ketyre dosjeve. | Është bërë evidentimi dhe njëkohëshisht dhe kërkesat për mbështëtje. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | nuk kemi pasur raste për mbështëtje në ekzekutim nga IMT | | | |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | nuk ka dosje me objekt lirimi dorzim objekti | | | nuk ka dosje |
| ZP Elbasan | ZP Elbasan nuk ka dosje momentalisht nuka ka çështje ku është dashur bashkepunimi me IKMT | | | |
| ZP Lushnjë | Janë përsëritur kërkesat çdo 6 muaj drejtuar IKMT-ës për mbështetje | mos reagimi I IKMT-së | Do vijohet të dergohen shkresa IKMT-se për mbështetje | relizuar |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | | | | përfunduar |
| ZP Korçë | Pranë Zyrës Përmbarimore Korçë nuk kemi asnjë dosje në proces ekzekutimi me objekt ‘’lirim dorëzim sendi’’,ku mungon mbështëtja instuticionale e IKMT. | | | I realizuar |
| ZP Fier | | | | Nuk ka dosje për mungesë mjetesh janë ekzekutuar 100 %.Fieri ka pasur dy dosje të mbartura te cilat janë ekzekutuar ne 2025 |
| ZP Sarandë | nuk kemi dosje në ekzekutim me këtë objekt | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Gjirokastër | evidentimi i një doje te mbartur | mungesë pajisjesh nga ana e tyre | është vijuar me dërgimin e shkresave për realizimin tereisht t e titullit ekzekutiv | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | | Nuk ka asnjë dosje | |
| ZP Tiranë | Janë marrë masat për përsëritjen e kërkesa për mbështetje në ekzekutim nga IMT në rastet kur ka qënë e nevojshme. | Ngarkesa që ka secili përmbaruesi nga volumi i punës dhe i dosjeve ka ndikuar në ngadalësimin e kryerjes së kësaj procedure. | Do të rishikohen të gjitha dosjet e mbartura ku është e nevojshme mbështetja në ekzekutim e IMT, do të vijohet me përsëritjen e kërkesave, dhe në rast të mosbashkpunimit, nëse jemi në kushtet ku mund të vijohet me sankione do të procedohet sipas legjislacionit nëfuqi. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | |
| ZP Shkodër | Nuk kemi asnjë dosje | | | Realizuar |
| Zyra Vendore Përmbarimore Kurbin | kemi ripërsëritur kërkesën për IMT dhe IKMT | nuk ka ardhur akoma përgjigje | ne viji do të procedohet sipas përgjigjes | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje te kësaj kategorie | | | |
| ZP Krujë | Zyra përmbarimore Krujë nuk ka dosje ku kërkohet mbështëtje I.M.T | nuk ka dosje në ekzekutim | | |
| ZP Pogradec | nuk kemi dosje në ekzekutim me këtë objekt | | | |
| ZP Përmet | nuk kemi dosje në ekzekutim me këtë objekt | | | |

**Masa: 1.6.3 Të njoftohet pala kreditore mbi nevojën e parapagimit të shpenzimeve përmbarimore në bazë të nenit 525 të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra përmbarimore Durrës në dosje që janë evidentuar ka njoftuar dhe palët kreditore mbi nevojën e parapagimit në zbatim të nenit 525 të K.Pr.Civile. | Kemi të bëjmë me palë që nuk kan mundësi ekonomike për ti mundësuar dhe ndaj ndodhemi në kushtet ku kërkohet mbështetje nga institucionet. | Zyra Përmbarimore do të intensifikojë kërkesat zyrtare për asistencë pranë IKMT-së dhe organeve të tjera kompetente. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | në të gjitha rastet, pala kreditore është njoftuar për parapagimin e shpenzimeve dhe është përgjigjur menjëhere | nuk kemi hasur problematika | | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Pukë | nuk ka dosje me objekt lirimi dorzim objekti | n | | nuk ka dosje |
| ZP Elbasan | Janë marrë masa për njoftimin e kreditorve mbi shpenzimet përmbarimore gjatë procedurës përmbarimore të cilët i janë përgjigjur shkresave tona për realizimin e shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit | Janë marrë masa për njoftimin e kreditorve mbi shpenzimet përmbarimore gjatë procedurës përmbarimore të cilët i janë përgjigjur shkresave tona për realizimin e shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit | Janë marrë masa për njoftimin e kreditorëve mbi shpenzimet përmbarimore gjatë procedurës përmbarimore të cilët i janë përgjigjur shkresave tona për realizimin e shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit | realizuar |
| ZP Lushnjë | Janë marrë masa për njoftimin e kreditorëve mbi shpenzimet përmbarimore gjatë procedurës përmbarimore të cilët i janë përgjigjur shkresave tona për realizimin e shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit | | | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | Pranë Zyrës Përmbarimore Vlorë nuk kemi asnjë dosje me këtë problematik | | | I realizuar |
| ZP Korçë | Pranë Zyrës Përmbarimore Korçë nuk kemi asnjë dosje në proces ekzekutimi me objekt ‘’lirim dorëzim sendi’’. | | | I realizuar |
| ZP Fier | | | | Nuk ka dosje për mungesë mjetesh janë ekzekutuar 100 %.Fieri ka pasur dy dosje të mbartura të cilat janë ekzekutuar në 2025 |
| ZP Sarandë | nuk kemi dosje në ekzekutim me këtë objekt | | | |
| ZP Gjirokastër | është bërë evidentimi dosjeve përmbarimore | paaftësi paguese nga pala kreditore | është vijuar me shkresat përkatëse për njoftim të përsëritur | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | | Nuk ka asnjë dosje në ekzekutim | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Tiranë | Në dosjet kur ka qënë e nevojshme parapagimi i shpenzimeve përmbarimore është kryer njoftimi i palëve kreditore. | Ngarkesa që ka secili përmbarues nga volumi i punës dhe i dosjeve ka ndikuar në ngadalësimin e kryerjes së kësaj procedure. | Do të rishikohen të gjitha dosjet e mbartura ku është e nevojshme do të bëhet kërkesa për parapagim të shpenzimeve përmbarimore në bazë të nenit 525 të K.Pr.Civile. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | |
| ZP Shkodër | është bërë evidentimi dosjeve përmbarimore | paaftësi paguese nga pala kreditore | do të vijohet me shkresat përkatëse për njoftim të përsëritur | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | më parë i kemi bërë kërkesë dhe na ka njoftuar që për shkak të konfliktit nuk mund të sigurojë dot vetë si palë kreditore mjete për prishje të tij duke kërkuar që të procedohet nga ana jonë me IKMT. | ndërtesa është katër kate me beton dhe nuk e saktësojmë dot vlerën e shpenzimeve që nëvojiten për prishje. Pra nuk mund ti kërkohet kreditorit një vlerë për shpenzimet për prishje kur nuk e kemi të përcaktuar se sa është kjo vlerë dhe për më tepër kur dispozita e ka përcaktuar se Inspektoriati detyrohet të na mbështësë sipas kërkesës tonë referuar nenit 523 te KPrC dhe nenit 42 të ligjit 8/2023. | | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | |
| ZP Krujë | Nuk ka dosje me objekt të tillë | nuk ka dosje në ekzekutim | | |
| ZP Pogradec | nuk kemi dosje në ekzekutim me këtë objekt | | | |
| ZP Përmet | nuk kemi dosje në ekzekutim me këtë objekt | | | |

**Masa: 1.6.4 Në rast se kreditori nuk përgjigjet sipas masës 1.6.3, brenda 3 muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësoshet pezullimi i ekzekutimit sipas nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Durrës është në procedura për të evidentuar dosjet sipas masës 1.6.3 dhe pas evidentimit ka kryer kërkesat përkatëse, ka vijuar me pezullimin e ekzekutimit në zbatim të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile. | | Do të vijoj procedurën deri në evidentimit dhe dhënien e një zgjidhjeje ligjore. | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | nuk kemi raste aktive me këtë problematikë | | | |
| Zyra Përmbarimore Pukë | | | | |
| ZP Elbasan | Do të evidentohen dosjet të cilave u është nisur shkresë për paraqitje sipas nenit 615/dh. Një pjesë e dosjeve janë në ekzekutim për pjesën e vjeljes së shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-së për pjesën e vjeljes së shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit si dhe një pjesë e kreditorëve të cilët janë njoftuar me shkresë për shprehje interesi në ekzekutimin e dosjes të cilët rezultojnë të larguar | Pas njoftimit të dytë është vijuar me pezullimin e tyre sipas nenit 615/dh | në proces |
| ZP Lushnjë | Do të evidentohen dosjet të cilave u është nisur shkresë për paraqitje sipas nenit 615/dh. Një pjesë e dosjeve janë në ekzekutim për pjesën e vjeljes së shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit (Eksperti dhe tarifa përmbarimore) | Mos pagimi i tarifave të aplikimit të ASHK-së për pjesën e vjeljes së shpenzimeve gjatë procesit të ekzekutimit si dhe një pjesë e kreditorëve të cilët janë njoftuar me shkresë për shprehje interesi në ekzekutimin e dosjes të cilët rezultojnë të larguar | Pas njoftimit të dytë do të vijohet me pezullimin e tyre sipas nenit 615/dh | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | Nuk ka problematik | | | realizuar |
| ZP Korçë | Pranë Zyrës Përmbarimore Korçë nuk kemi asnjë dosje në proces ekzekutimi me objekt ''lirim dorëzim sendi''. | | | I realizuar |
| ZP Fier | | | | Nuk ka dosje për mungesë mjetesh janë ekzekutuar 100 %.Fieri ka pasur dy dosje të mbartura te cilat janë ekzekutuar ne 2025 |
| ZP Sarandë | nuk kemi dosje me këtë objekt | | | |
| ZP Gjirokastër | do të vijohet me njoftimin e dytë shkresor | në pritje të afatit 3 mujor | pas kalimit të afatit 3 mujor do të procedohet me pezullimin | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | Nuk kemi pasur Problematika . | Nuk ka asnjë dosje në ekzekutim | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyrat Përmbarimore Tiranë | shumica e çështjeve janë në proces dhe për disa çështje është kryer edhe faza e pezullimit | Ngarkesa që ka secili përmbaruesi nga volumi i punës dhe i dosjeve ka ndikuar në ngadalësimin e kryerjes së kësaj procedure. | Do të priten përgjigjet dhe gatishmëria e palëve kreditore në rast mospërgjigje do të vlerësohet mundësia për pezullim nëse jemi brënda parashikimeve të kuadrit ligjor. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | |
| ZP Shkodër | do të vijohet me njoftimin e dytë shkresor | në pritje të afatit 3 mujor | pas kalimit te afatit 3 mujor do të procedohet me pezullimin | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | | | | |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | |
| ZP Krujë | Nuk ka dosje me objekt të tillë | | | |
| ZP Pogradec | nuk kemi dosje me këtë objekt | | | |
| ZP Përmet | nuk kemi dosje me këtë objekt | | | |

<table>
<tr><td colspan="3">Masa Nr.1.7<br>Vlerësimi i dosjeve përmbarimore të mbartura me objekt “shpenzime gjyqësore” ku palëve debitore nuk i dihet adresa e banimit dhe detyrimi në të hodha është në vlerë shumë të ulët në raport me shpenzimet përmbarimore.</td></tr>
<tr><td>Përshkrimi i problemit:</td><td colspan="2">Një numër i konsiderueshëm i dosjeve përmbarimore të mbartura kanë objekt kthimin e një shumë të vogël lekësh si përshembull dosjet me objekt “shpenzime gjyqësore”, ku vlera mund të jetë edhe 500 lekë deri në 5000 lekë, ndërkohë që debitorët nuk janë njoftuar për shkak të mungesës së adresave të sakta. Në këto raste, kostot e kërkimit të përfaqësuesit ligjor apo të procedurave përmbarimore janë më të larta se vetë shuma objekt ekzekutimi. Kjo situatë sjellë mosmbylljen e procedurës përmbarimore duke rritur numrin e dosjeve përmbarimore të mbartura ndër vite.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.7.1 Të ripërsëriten procedurat përmbarimore për gjetjen e adresës së saktë të palës debitore.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.7.2 Në rast të mos realizimit të njoftimit të palës debitore, pavarësisht të gjithë procedurës përmbarimore shteruese të përmbaruesit gjyqësor, të njoftohet prokuroria kompetente mbi marrjen e masës për dhënien e zgjidhjes ligjore.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.7.3 Në rast se prokuoria nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësoshet pezullimi i ekzekutimit në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Kompetenca:</td><td>Institucion përgjegjës</td><td>Institucion kontribues</td></tr>
<tr><td>22 Zyrat Vendore Përmbarimore</td><td>Prokuroria, Zyra e Gjendjes Civile, Policia e Shtetit</td></tr>
<tr><td>Burimet:</td><td>Kryetarët<br>Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë</td><td></td></tr>
<tr><td>Koha:</td><td>Kohëzgjatja: 2025-2030</td><td>Faza :</td></tr>
</table>

**Masa 1.7 Vlerësimi i dosjeve përmbarimore të mbartura me objekt “shpenzime gjyqësore”, ku palëve debitore nuk u dihet adresa e banimit dhe detyrimi në të holla është dukshëm më i ulët se shpenzimet përmbarimore**

**Progresi**

Zyra Përmbarimore Durrës dhe Krujë kanë evidentuar të gjitha dosjet përmbarimore me objekt shpenzime gjyqësore ku pala debitore nuk ka adresë të saktë dhe ku vlera e detyrimit është më e ulët se shpenzimet gjyqësore. Për disa dosje, janë ripërsëritur kërkesat për saktësimin e adresave pranë Gjendjes Civile, Komisariatit të Policisë dhe organeve kompetente administrative. Janë përfshirë në proces mbi 65 dosje për të cilat po kryhet verifikimi i adresave dhe njoftimi i palëve debitore. Zyra Durrës po bashkëpunon me Policinë e Shtetit për lokalizimin e debitorëve, duke njoftuar debitorët që të paraqiten pranë Zyrës Përmbarimore. Zyra Korçë ka bashkëpunuar me

Gjendjen Civile, Komisariatin e Policisë, Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit dhe rajonet administrative për të lokalizuar debitorët dhe për të likuiduar detyrimet. Zyra Krujë ka vijuar procedurat për evidentimin dhe përcaktimin e vendbanimit të debitorëve, përfshirë kërkesat pranë gjendjes civile dhe komisariatit. Për rastet ku debitorët nuk lokalizohen dhe detyrimi është i vogël, po përgatitet dokumentacioni mbështetës për referim pranë prokurorisë. Prokuroritë përkatëse (Tiranë, Lezhë) janë njoftuar dhe po pritet përgjigjja për masat që do të merren. Në mungesë bashkëpunimi nga prokuroria, do të procedohet sipas nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.
Janë ripërsëritur njoftimet për gjetjen e adresave, lokalizimin e debitorëve dhe ekzekutimin e detyrimeve ku është e mundur. Janë ekzekutuar dosje me buxhet shteti të mbartura nga viti i kaluar. Procesi i vlerësimit dhe kategorizimit të dosjeve vazhdon, duke përfshirë edhe rastet me detyrime shumë të vogla (deri 5,000 lekë). Evidentimi i dosjeve është në process. Njoftimi i palëve kreditore dhe debitorëve është kryer, duke përsëritur kërkesat kur ka pasaktësi të dhënash. Procedurat do të vazhdojnë sipas ecurisë së çdo çështjeje, duke përfshirë referimin pranë prokurorisë për rastet ku debitorët nuk gjenden.

**Problematika**

- Adresat e pasakta: Debitorët rezultojnë të regjistruar në një vend dhe banojnë diku tjetër, shpesh edhe jashtë shtetit.
- Mungesë bashkëpunimi nga disa palë kreditore për të dhënë të dhëna të sakta mbi debitorët.
- Vlera e ulët e detyrimit në shumë dosje, krahasuar me shpenzimet proceduriale, e bën ekonomikisht joefikas vazhdimin e ekzekutimit.
- Përgjigje të vonuara ose mungesë përgjigjeje nga prokuroritë pas njoftimeve zyrtare.
- Ngarkesa e lartë e punës për evidentim dhe verifikim, sidomos kur kërkesat dërgohen në grupe për të ulur kostot.

**Hapat në vijim**

- Përfundimi i evidentimit të plotë të dosjeve të mbartura në të gjitha zyrat.
- Rikërkimi i adresave pranë Gjendjes Civile dhe verifikimi në sistemin TIMS për debitorët që dyshohet të jenë jashtë shtetit.
- Dërgimi i njoftimeve të dyta zyrtare për prokuroritë që nuk kanë kthyer përgjigje.
- Pezullimi i procedurës së ekzekutimit në rastet ku plotësohen kushtet e nenit 615/dh të K.Pr.Civile.
- Njoftimi i vazhdueshëm i palëve kreditore dhe kërkesa për të dhëna shtesë mbi debitorët.

**Statusi**

Pjesa më e madhe e zyrave kanë përfunduar pjesërisht evidentimin dhe po vijojnë me procedurat për gjetjen e adresave. Disa zyra kanë kaluar në fazën e njoftimit të prokurorisë. Pezullimet sipas nenit 615/dh janë ende në fazë vlerësimi, nuk ka vendime përfundimtare në shumicën e rasteve.

**Masa: 1.7.1 Të ripërsëriten procedurat përmbarimore për gjetjen e adresës së saktë të palës debitore.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës po vijon me evidentimin e dosjeve me objekt shpenzime gjyqësore ku pala debitore nuk ka adresë të saktë dhe me kërkesën gjendjes civile. | | Është në proces evidentimi të dosjeve dhe për të ulur kostet e shpenzimeve kërkesat për këto dosje behen në grupe | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | pas çdo kthimi te zarfave nga posta për arsye se debitorët nuk gjenden, i jemi drejtuar Z.Gj.Civile për saktësimin e adresave | problematika kryesore e adresave është se palët figurojnë të regjistruar dikund tjetër dhe jetojnë dikund tjetër apo dhe jashtë shtetit | masat që do merren për rastet kur në zarf shënohet larguar jashtë shtetit është me kërkim informacioni pranë Komisariateve për verifikim në sistemin TIMS | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | Kemi evidentuar të gjitha dosjet që kanë pasaktësi dhe mungesë informacioni me adresë dhe i jemi drejtuar për bashkëpunim dhe informacion shtesë Policisë se Shtetit si dhe Z.Gjendjes Civile në Bashkitë Përkatëse | | në vijim do të procedojmë më tej me verifikimet përkatëse | në proces |
| ZP Elbasan | Janë përsëritur njoftimet nëpërmjet policisë së shtetit për vendodhjen e debitorëve | | Është vijuar dhe vijohet me veprimet e nevojshme për gjetjen e debitorëve | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë përsëritur njoftimet nëpërmjet policisë së shtetit për lokalizimin e debitorëve dhe njoftimin e tyre që të paraqiten në Zyrën e Përmbarimit | | Do të vijohet që kryen veprimet e nevojshme për gjetjen e debitorëve | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | në proces | | | përfunduar |
| ZP Korçë | Zyra Përmbarimore Korçë ka ndjekur të gjitha procedurat që parashikon ligji për gjetjen e adresës se debitorit në bashkëpunim me organet kompetente si Gjendja Civile, Komisariati i Policisë, Bashki, Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit Korçë. Gjithashtu përgjatë muajit dhjetor është intesifikuar bashkëpunimi dhe komunikimi me policinë e shtetit, dhe në veçanti me inspektorët e zonave përkatëse, sipas adresave të debitorëve, duke u bërë i mundur lokalizimi i tyre dhe likujdimi i detyrimit. | Vështirësi në njoftimin e debitorëve për shkak të mospërputhjes së adresave. Në disa raste , megjithëse debitori rezulton i regjistruar në një adresë sipas të dhënave të Gjendjes Civile, gjatë përpjekjeve për njoftim është konstatuar se debitori nuk banon në atë adresë. Kjo krijon vështirësi reale në realizimin e njoftimit personal dhe zvarrit procesin përmbarimor, pasi kërkon verifikime shtesë dhe kohë për gjetjen e vendndodhjes së saktë të debitorit. Gjatë ekzekutimeve në terren është konstatuar se një pjesë e debitorëve ndodhen të larguar jashtë shtetit. | Do të kërkohet bashkëpunimi i Bashkive dhe Njësive Administrative, nëse debitorët sipas ligjit kanë deklaruar adresë të re banimi, si dhe përdorimi i mjeteve alternative të njoftimit sipas parashikimeve ligjore. Do të vijojë bashkëpunimi me Policinë e Shtetit, si një mjet i domosdoshem dhe efektiv për lokalizimin e debitorëve, veçanërisht në rastet e dosjeve ku adresat rezultojnë të pasakta apo të papërditësuara. | Në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Fier | Dosje me buxhet shteti të mbartur nga viti i mëparshëm janë ekzekutuar mbi 50 | Volumi i punës | Do tentojmë njoftimin e 1200 debitorëve sipas planit të brendshëm të Zyrës Fier për uljen e stokut | Në proces |
| ZP Sarandë | Për disa nga dosjet që janë evidentuar dhe kërkuar me shkresë gjetja e adresës | adresat rezultojnë të pasakta | do rikërkohet adresë në gjendjen civile dhe në komisariate | në proces |
| ZP Gjirokastër | Është bërë evidentimi i dosjeve përmbarimore të mbartura që janë në proces me objekt shpenzime proceduriale me vlerë të vogël | Adresat rezultojnë të pasakta si dhe ka debitore me gjeneralitete të pasakta | është vijuar me shkresa drejtuar Gjendjes Civile për vendosjen në dispozicion të adresave të sakta | në proces |
| ZP Tropojë | Në proces | Nuk kemi pasur Problematika . | Janë kerkuar cerftifikatat personale të debitorëve | Në proces |
| Zyrat Vendore Përmbarimore Tiranë | Kemi bërë evidentimin e tyre dhe po merremi me dërgimin e listave pranë Gjendjes Civile por ka një numër të lartë çështjesh që janë me objekt shpenzime gjyqësore | Për të kryer këtë vlerësim kërkon më shumë kohë pasi këto çështje përbëjnë ngarkesën me të lart të gjithë objekteve dhe një problem të theksuar që e rrit stokun e këtyre dosjeve ka të bëjë me faktin që debitorët nuk kanë adresa të sakta në gjeneralitet e gjyaktës dhe për pasojë postierët nuk i dërgojnë njoftimet dhe i kthejnë mbrapsht me shënimin adresë e pasaktë. Gjendja Civile vonon shumë për kthimet e përgjigjeve, kemi patur problematika edhe me këtë institucion për shkak se ka autorizuar Drejtoria e tyre e përgjithshme vetëm Njësine nr.7 për dhënien e përgjigjeve ndaj sherbimit tonë dhe ka patur shumë vonesa në kthimin e tyre, duke ngadalësuar edhe procesin e kësaj faze. Pa i shtuar këtu edhe faktin që as gjendja civie nuk i ka adresat e plotë apo të sakta sepse një pjesë e mirë tyre kthehen mbrapsht përsëri nga posta dhe kjo përkthehet në kohë të humbur në afatet e arsyeshme të ekzekutimit dhe në kosto financiare për zyrën pa rezultatin e dëshiruar | Në vijim ne varesi te informacioneve te eprcjella nga Gjendja Civile do të procedojme me procedurat e metejshme përmbarimore rast pas rasti | Në proces |
| ZP Dibër | Nga Zyra Përmbarimore janë përsëritur procedura përmbarimore për gjetjen e adresave të sakta të debitorëve dhe jemi në pritje të përgjigjes për përcakimin e saktë të vendbanimit. | Problematika e hasur qëndron pasi vendbanimi dhe vendqëndrimi i debitorit është i ndryshëm. | Stafi i Zyrës Përmbarimore po bën ç'është e mundur për të gjetur adresën e saktë të debitorëve. | Në proces. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Shkodër | Është bërë evidentimi i dosjeve përmbarimore të mbartura që janë në proces me objekt shpenzime procedurale me vlerë të vogël | Adresat rezultojnë të pasakta | është vijuar me shkresa drejtuar Gjendjes Civile për vendosjen ne dispozicion të adresave të sakta | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë po marrim masat që, gradualisht, të evidentojmë vendbanimin e palëve debitore që nuk marrin njoftimet, për të përcaktuar nëse ndodhen në Rrethin e Kurbinit ose kanë ndryshuar vendbanimin. Në korrik kemi pasur 12 raste, nga të cilat 1 ishte jashtë territorit, 1 ka rezultuar të jetë banor i Krujës, dhe 3 kanë përmbushur detyrimet e tyre pas njoftimit nga policia. | | në vijim do të proceodjme me tej me verifikimet përkatëse | në proces |
| ZP Kukës | Nga Zyra Përmbarimore janë përsëritur procedura përmbarimore për gjetjen e adresave drejtuar Zyrës se Gjendjes Civile. | | | Në proces. |
| ZP Mat | janë dërguar kërkesat zgj.civile për 65 -dosje | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Zyra përmbarimore Krujë po vijon me evidentimin e dosjeve me objekt shpenzime gjyqësore ku pala debitore nuk ka adresë të saktë dhe ku vlera e detyrimit në të holla është me e ulët se shpenzimet e procedurës përmbarimore. | adresa e pasakte | Po bëhet evidentimi i këtyre dosjeve dhe po bën kërkesat drejtuar gjendjes civile për konfirmim adresash | Në proces |
| ZP Pogradec | Për disa nga dosjet që janë evidentuar është rikërkuar me shkresë gjetja e adresës në komisariat dhe gjendjen civile | adresat rezultojnë të pasakta | do rikërkohet adresa në gjendjen civile dhe në komisariate për dosjet e mbetura për ti dhënë me pas zgjidhje ligjore | në proces |
| ZP Përmet | Për disa nga dosjet që janë evidentuar është kerkuar me shkresë gjetja e adresës | adresat rezultojnë të pasakta | do rikërkohet adresë në gjendjen cicile dhe në komisariate | në proces |

**Masa: 1.7.2 Në rast të mos realizimit të njoftimit të palës debitore, pavarësisht të gjithë procedurës përmbarimore shteruese të përmbaruesit gjyqësor, të njoftohet prokuroria kompetente mbi marrjen e masës për dhënien e zgjidhjes ligjore.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës nuk e ka vijuar këtë procedurë deri më tani, pasi po kryen evidentimin e plotë të dosjeve përkatëse dhe po finalizon dokumentacionin mbështetës, në mënyrë që referimi pranë prokurorisë të bëhet mbi bazën e të dhënave të sakta dhe të verifikuara. | | | Në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Lezhë | për gjobat penale kemi vënë në dijeni prokurorinë kur debitorët nuk gjenden, | problematikë është se ndonjëhere vlera e detyrimit është me e vogël se sa shpenzimet proceduralet tonat. | do njoftojmë prokurorinë dhe për shpenzimet proceduriale për të cilat debitorët nuk gjenden | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | Do të njoftojme prokurorinë për çdo rast për zgjidhjet që do të marrë rasti | Duke qëne se është parashikuar ne K.Pr.C që procedura e njoftimit te bëhet me shpallje, do të kryhen të gjitha fazat proceduriale të ekzekutimit të detyruar dhe sipas rastit do të njoftojmë prokuroritë për zgjidhjet dhe për orientimin e dhënë nga DPP për këto raste shkresërisht. | | në proces |
| ZP Elbasan | Janë duke u evidentuar dosjet ku palët nuk kanë marr dijeni si dhe u është dërguar kërkesë palëve kreditore të vënies në dispozicion të të dhënave të sakta pasi ka rezultuar se disa urdhëra ekzekutimi kanë qënë gabim të dhënat e debitorëve | | Do të vijohet me njoftimin e prokurorive mbi dosjet të cilat palët nuk kanë marrë njoftim | në proces |
| ZP Lushnjë | Janë evidentuar dosjet ku palët nuk kanë marr dijeni si dhe u është dërguar kërkesë palëve kreditore të vënies në dispozicion të të dhënave të sakta pasi ka rezultuar se në disa urdhëra ekzekutimi kanë qënë gabim të dhënat e debitorëve | | Do të vijohet me njoftimin e prokurorive mbi dosjet të cilat palët nuk kanë marrë njoftim | në proces |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | | | Do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore që parashikon Kodi i Procedures Civile për njoftimin e debitorit. | Në proces |
| ZP Korçë | | | Do të ndiqen të gjitha procedurat ligjore që parashikon Kodi i Procedures Civile për njoftimin e debitorit. | Në proces |
| ZP Fier | Dosje me buxhet shteti të mbartur nga viti i mëparshëm janë ekzekutuar mbi 50 | Volumi i punës | Do të tentojmë njoftimin e 1200 debitorëve sipas planit të brendshëm të Zyrës Fier për uljen e stokut | Në proces |
| ZP Sarandë | | Nuk kemi pasur probleme | | në proces |
| ZP Gjirokastër | është vijuar me evidentimin në total të dosjeve përmbarimore të mbartura që | nuk kemi pasur probleme | nëse pala kreditore nuk bashkëpunon paguan shpenzimet do procedohet 615/dh | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | janë në proces me objekt shpenzime proceduriale me vlerë të vogël | | | |
| ZP Tropojë | Në proces | Nuk kemi pasur Problematika . | Do bëhen njoftimet përkatëse palës kreditore | Në proces |
| Zyrat Vendore Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor janë në fazë vlerësimi dhe kategorizimi të këtyre dosjeve. | Për të kryer këtë vlerësim kërkon më shumë kohe pasi këto çështje përbëjnë ngarkesën me të lart te të gjithë objekteve dhe një problem të theksuar që e rrit stokun e këtyre dosjeve ka të bëjë me faktin që debitorët nuk kanë adresa të sakta në gjeneralitet e gjykatës dhe për pasojë postierët nuk i dërgojnë njoftimet dhe i kthejnë mbrapsht me shënimin adresë e pasaktë. Gjendja Civile vonon shumë për kthimet e përgjigjeve, kemi patur problematika edhe me këtë institucion për shkak se ka autorizuar Drejtoria e tyre e përgjithshme vetëm Njësine nr.7 për dhënien e përgjigjeve ndaj shërbimit tonë dhe ka patur shumë vonesa në kthimin e tyre, duke ngadalësuar edhe procesin e kësaj faze. Pa i shtuar këtu edhe faktin që as gjendja civile nuk i ka adresat e plotë apo të sakta sepse një pjesë e mirë e tyre kthehen mbrapsht përsëri nga posta dhe kjo përkthehet në kohë të humbur në afatet e arsyeshme të ekzekutimit dhe në kosto financiare për zyrën pa rezultatin e dëshiruar | Në vijim në varësi të informacioneve të përcjella nga Gjendja Civile do të procedojmë me procedurat e mëtejshme përmbarimore rast pas rasti | Në proces |
| ZP Dibër | | | | |
| ZP Shkodër | Do të vijohet me evidentimin e dosjeve përmbarimore të gjitha të mbartura që janë në proces me objekt shpenzime proceduriale me vlerë të vogël | nuk kemi pasur probleme | nëse pala kreditore nuk bashkepunon paguan shpenzimet do procedohet 615çdh | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Prokuroria e Tiranës është njoftuar mbi rastin. | Duke qëne se është parashikuar ne K.PR.C që procedura e njoftimit te bëhet me shpallje, do të kryhen të gjitha fazat proceduriale të ekzekutimit të detyruar dhe sipas rastit do të njoftojmë prokuroritë për zgjidhjet dhe për orientimin e dhënë nga DPP për këto raste shkresërisht. | | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | U.Sekuestro ASHK për 65 dosje ( për kreditorin) | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë e ka vijuar këtë procedurë | | . | |
| ZP Pogradec | jemi në proces gjatë muajit nëntor dhe ne vazhdim për selektimin e dosjeve me shumë të vogël deri 5000 lekë | nuk kemi pasur probleme | nëse pala kreditore nuk bashkëpunon paguan shpenzimet do procedohet 615/dh | në proces |
| ZP Përmet | | nuk kemi pasur probleme | | në proces |

**Masa: 1.7.3 Në rast se prokuoria nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi i dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësoshet pezullimi i ekzekutimit në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës nuk e ka vijuar këtë procedurë deri më tani, pasi po kryen evidentimin e plotë të dosjeve përkatëse dhe po finalizon dokumentacionin mbështetës, në mënyrë që referimi pranë prokurorisë të bëhet mbi bazën e të dhënave të sakta dhe të verifikuara. | | | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | për muajin Dhjetor nuk kemi dosje të proceduara me nenin 615/dh | | | në proces |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | për rastet që do të kërkohet dhe prokuroritë nuk përgjigjen nga ana jonë do të proceëdohet sipas orientimti tuaj | | | në proces |
| ZP Elbasan | Prokuroritë respektive janë njoftuar me shkresë se nëse nuk bashëpunojnë do të procedohet sipas nenit 615/dh | | Prokuroritë respektive janë njoftuar me shkresë se nëse nuk bashëpunojnë do të procedohet sipas nenit 615/dh | në proces |
| ZP Lushnjë | Prokuroritë respektive janë njoftuar me shkresë se nëse nuk bashëpunojnë do të procedhet sipas nenit 615/dh | | Do të përsëritet njoftimi sipas nenit 615/dh për prokuroritë | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | të cilat nuk kanë kthyer asnjë përgjigje. | |
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | | | | Në proces |
| ZP Korçë | | | Do të veprohet sipas përcaktimit të masës 1.7.3 | Në proces |
| ZP Fier | Dosje me buxhet shteti të mbartur nga viti i mëparshëm janë ekzekutuar mbi 50 | Volumi i punës | Do të tentojmë njoftimin e 1200 debitorëve sipas planit të brendshëm të Zyrës Fier për uljen e stokut | Në proces |
| ZP Sarandë | | | | në proces |
| ZP Gjirokastër | Gjatë muajit janë evidentuar rastet | nuk është plotësuar afati 3 mujor | Do vlerësohet pezullimi pasi të jenë evidentuar dhe kaluar 3 mujori I njoftimit | në proces |
| ZP Tropojë | Në proces | Nuk kemi pasur Problematika . | Do bëhen vlerësimet përkatëse | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Tiranë | Pëmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me procedurat si me sipër dhe në vijim do të vijohet sipas rastit dhe ecurisë se çdo çështjeve përmbarimore | Jemi në pritje të përgjigjeve të Gjendjes civile. Problematikë është fakti që DRSHTRR dhe ASHK nuk kthejnë përgjigje | Do të procedojmë rast pas rasti për çdo çështje përmbarimore | Në proces |
| ZP Dibër | | | Në rastet kur prokuroria nuk do të përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi shkresor të bërë nga përmbaruesi gjyqësor do të procedohet në bazë të nenit 615/dh të Kodit Pr.Civile. | Në proces. |
| ZP Shkodër | janë evidentuar rastet | nuk është plotësuar afati 3 mujor | Do vlerësohet pezullimi pasi të jenë evidentuar dhe kaluar 3 mujori njoftimit | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | Prokuroria e Tiranës është njoftuar mbi rastin, por deri më tani nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Prokuroria e Lezhës, siç u përmend më lart, ka njoftuar se nuk disponon fonde për mbulimin e shpenzimeve të vendimeve penale. | | | në proces |
| ZP Kukës | | | | |
| ZP Mat | është bërë vetëm njoftimi i dytë për 65 dosje | | Në pritje të plotësimit të afateve | në proces |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë nuk e ka vijuar këtë procedurë deri më tani | | | |
| ZP Pogradec | Gjatë muajit nëntor janë evidentuar një pjesë e rasteve | nuk është plotësuar afati 3 mujor | Do vlerësohet pezullimi pasi të jenë evidentuar dhe kaluar 3 mujori njoftimit | në proces |
| ZP Përmet | | | | në proces |

<table>
<tr><td colspan="3">Masa Nr.1.8<br>Trajtimi i dosjeve përmbarimore me objekt “gjoba administrative” ku pala debitore është subjekt që përfiton nga Ligji nr.127/2024 “Për Shfuqizimin e Masave Administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri me 30 Nentor 2024” dhe VKM nr. 274/2025 "Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative"</td></tr>
<tr><td>Përshkrimi i problemit:</td><td colspan="2">Në kuadër të Marrëveshjes së dt. 28 Maj me Shërbimin e Provës dhe në zbatim të Ligjit nr.127/2024 “Për Shfuqizimin e Masave Administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri me 30 Nentor 2024” dhe VKM nr. 274/2025 "Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative", lind nevoja e marrjes e masave për vlerësimin dhe evidentimin e titujve ekzekutivë me objekt gjobë administrative, me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore të këtyre çështjeve.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.8.1 Hartimi i një liste me dosjet përmbarimore ku pala debitore është subjekt që përfiton nga Ligji nr. 127/2024.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.8.2 Dërgimi i listës palës kreditore kompetente me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore, konform nenit 616 të Kodit të Procedurës Civile.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Masa: 1.8.3 Në rast se pala kreditore (shteti kreditor) nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësohet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Kompetenca:</td><td>Institucion përgjegjës</td><td>Institucion kontribues</td></tr>
<tr><td>22 Zyrat Vendore Përmbarimore</td><td>Pala kreditore</td></tr>
<tr><td>Burimet:</td><td>Kryetarët<br>Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë</td><td></td></tr>
<tr><td>Koha:</td><td>Kohezgjatja: 2025-2030</td><td>Faza :</td></tr>
</table>

**Masa 1.8 Trajtimi i dosjeve përmbarimore me objekt “gjobë administrative”, ku pala debitore është subjekt që përfiton nga Ligji nr. 127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 Janar 2015 deri në 30 Nëntor 2024” dhe VKM nr. 274/2025 “Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative”.**

**Progresi**

Janë evidentuar pothuajse të gjitha dosjet përmbarimore që përfitojnë nga amnistia ligjore. Përmbaruesit gjyqësorë kanë hartuar listat e palëve debitore që përfitojnë nga ligji nr. 137/2024 dhe këto lista janë përcjellë pranë institucioneve përkatëse për konfirmim. Për rastet ku nuk ka përgjigje të menjëhershme nga institucionet, po vijon procedura e pritjes së përgjigjeve zyrtare. Janë dërguar të gjitha listat e dosjeve përmbarimore ku debitori përfiton nga ligji nr. 137/2024, me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore sipas nenit 616 të Kodit të Procedurës Civile. Ku palët kreditore nuk kanë përgjigjur brenda tre muajve nga njoftimi i dytë, do të vijojë procedura sipas nenit 615/dh

të Kodit të Procedurës Civile. Në rastet e konfirmuara, disa palë kreditore kanë kërkuar pushimin e ekzekutimit sipas ligjit. Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me kategorizimin dhe verifikimin e dosjeve. Nuk ka raste të pazgjidhura që kërkojnë veprime shtesë jashtë afateve të parashikuara nga ligji. Hartimi i listave dhe njoftimi i palëve kreditore janë kryer dhe në pritje të përgjigjeve zyrtare.

**Problematika**

- Mungesa e përgjigjeve nga një pjesë e institucioneve kreditore, edhe pas dërgimit të kërkesave të përsëritura.
- Vonesa në procesin e verifikimit nga palët kreditore për shkak të ngarkesës së punës.
- Rastet e mosidentifikimit të dosjeve të mbartura që përfitojnë nga ligji në disa zyra.
- Zvarritje të procedurës për shkak të nevojës për konfirmim zyrtar nga institucione të ndryshme për çdo debitor.

**Hapat në vijim**

- Përsëritja e njoftimeve për palët kreditore që nuk kanë kthyer përgjigje brenda afatit ligjor.
- Pezullimi i ekzekutimit të dosjeve sipas nenit 615/dh për rastet kur nuk ka përgjigje pas njoftimit të dytë.
- Arkivimi i dosjeve pas marrjes së konfirmimit të pushimit nga kreditori.
- Ndjekja e procedurave individuale për çdo subjekt përfitues dhe dërgimi i kërkesave të përsëritura me listat përfundimtare.
- Përfundimi i verifikimit të mbetur në disa zyra ku procesi është ende në fazë fillestare.

**Statusi**

Shumica e zyrave e kanë realizuar plotësisht evidentimin dhe hartimin e listave. Disa zyra janë në proces për dërgimin e listave ose presin përgjigje nga kreditorët. Pezullimet sipas nenit 615/dh janë kryesisht në fazë vlerësimi ose pritjeje.

**Masa: 1.8.1 Hartimi i një liste me dosjet përmbarimore ku pala debitore është subjekt që përfiton nga Ligji nr. 127/2024.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës çdo përmbarues në përbërje të saj ka hartuar listën ku pala debitore është përfitues i Ligjit nr.127/2024 | | Ka bërë listat dhe kërkesat për çdo institucion. | Realizuar |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | është hartuar lista e ketyre gjobave administrative dhe është përcjellë pranë Instutucioneve të IMT-ve | IMT-Bashkia Lezhë nuk ka kthyer përgjigje akoma | | realizuar |
| Zyra Vendore Përmbarimore Pukë | nuk kemi çështje te tille | nuk ka | | nuk ka dosje |
| ZP Elbasan | ZP Elbasan nuk ka çështje me debitorë që përfitojnë nga ligji 127/2024 | | ZP Elbasan nuk ka çështje me debitore që përfitojnë nga ligji 127/2024 | |
| ZP Lushnjë | Është bërë evidentimi dhe hartimi i listave të debitorëve të cilët përfitojnë nga ligji 127/2024 | | Janë hartuar listat dhe u janë nisur kreditorëve të sjellin kërkesë për pushimin e urdhrit të ekzekutimit | realizuar |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Vendore Vlorë | përfunduar | | | përfunduar |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100% prej muajit korrik 2025. | | | I realizuar |
| ZP Fier | Nuk ka progres pasi nuk kemi përgjigje nga institucionet | | Mbetemi në pritje kthim përgjigjes | Në proces |
| ZP Sarandë | është bërë evidentimi i rasteve. | nuk kemi pasur probleme | | proces |
| ZP Gjirokastër | është bërë hartimi i listës së palëve debitore drejtuar AKU Gjirokastër, në rast se janë përfitues apo jo të Ligjit | Kemi pasur bashkëpunim institucional | Jemi në pritje të përgjigjes nga ana e institucionit | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | Nuk kemi pasur Problematika . | | I realizua 100% |
| Zyrat Vendore Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me hartimin e listave me dosjet përmbarimore ku pala debitore është subjekt që përfiton nga shfuqizimi i masave dhe aktualisht jemi në pritje të përgjigjeve te IMT dhe IKMT | Janë dërguar për një sërë çështjesh shkresat dhe akoma nuk kanë ardhur përgjigjet. | Janë dërguar për një sërë çështjesh shkresat dhe akoma nuk kanë ardhur përgjigjet. | në proces |
| ZP Dibër | Është bërë hartimi listës nga ana e Zyrës Përmbarimore për palët debitore që përfitojnë nga ligji 127/2024, gjithashtu nga pala debitore nga është konfirmuar se debitorët përfitojnë nga amnistia. | | | I realizuar. |
| ZP Shkodër | realizuar | realizuar | realizuar | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | janë evidentuar dosjet nga secili përmbarues për zyrën | është proceduar konform ligjit dhe i është kërkuar IMT-së për secilin rast konfirmimi nëse është subjekt përfitues | | realizuar |
| ZP Mat | hartuar lista me dosje të arkivës | | pritje të kërkesës kreditorit | I realizuar |
| ZP Krujë | Zyrës Përmbarimore Krujë ka kryer evidentimin e pothuajse të plotë të dosjeve që përfitojnë nga amnistia, duke ndjekur procedurat ligjore për zbatimin e ligjit të aminstisë 33/2024, si dhe dosjet ku gjen zbatim ligji “Për shfuqizimin e masave administrative” sipas VKM Nr.274/25 | Mos kthim përgjigje nga kreditori shpejt në lidhje me pushimin | Ka bërë listat dhe kërkesat për çdo institucion. | Realizuar |
| ZP Pogradec | nuk kemi evidentuar dosje të mbartura që përfitojnë sipas ligjit | nuk kemi pasur probleme | | realizuar |
| ZP Përmet | është bërë evidentimi i rasteve. | nuk kemi pasur probleme | | proces |

**Masa: 1.8.2 Dërgimi i listës palës kreditore kompetente me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore, konform nenit 616 të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra Përmbarimore Durrës kërkesat palës kreditore ja ka dërguar si kur doli ligji dhe gjithashtu kur doli VKM. | Kreditori nuk na jep një përgjigje për ti dhënë një zgjidhje ligjore konform nenit 616 K.Pr.Civile | Do të vijoj si me kërkesa individuale për çdo subjekt përfitues si dhe kërkesë të përsëritur me listën e subjekteve përfitues. | Realizuar |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | është realizuar dërgimi i listës drejtuar kreditorit | IMT-Bashkia Lezhë nuk ka kthyer përgjigje akoma | do presim për përgjigjen e IMT-Bashkia Lezhë | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | nuk ka | nuk ka | nuk ka | nuk ka dosje |
| ZP Elbasan | ZP Elbasan nuk ka dosje të debitorëve të cilët përfitojnë nga ligji 127/2024 | | ZP Elbasan nuk ka dosje me debitore që përfitojnë nga ligji127/2024 | |
| ZP Lushnjë | Është bërë evidentimi dhe hartimi i listave të debitorëve të cilët përfitojnë nga ligji 127/2024 | | Janë hartuar listat dhe janë nisur kreditorëve të sjellin kërkesë për pushimin e urdhrit të ekzekutimit | realizuar |
| Zyra Përmbarimore Vlorë | | | | përfunduar |
| ZP Korçë | Kjo masë është realizuar 100 %, pasi që prej muajit gusht 2025, bazuar në shkresën nr.5386/1 Prot., datë 31.07.2025 te Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, me anë të së ciles ka kërkuar pushimin e ekzekutimit në bazë të nenit 616/b të K.Pr.Civile, nga ana jonë janë pushuar në bazë të nenit 616/b të K.Pr.Civile 90 gjoba administrative të vendosura gjatë përiudhës së COVID 2019. | Nuk kemi hasur asnjë problematikë | | I realizuar |
| ZP Fier | Nuk ka progres pasi nuk kemi përgjigje nga institucionet | | Mbetemi në pritje të kthim përgjigjes | Në proces |
| ZP Sarandë | | | | Realizuar |
| ZP Gjirokastër | | | | në proces |
| ZP Tropojë | Plotësisht | Nuk kemi pasur Problematika . | | I realizuar 100% |
| Zyrat Vendore Përmbarimore Tiranë | Përmbaruesit gjyqësor kanë vijuar me hartimin e listave me dosjet përmbarimore ku pala debitore është subjekt që përfiton nga shfuqizimi i masave dhe aktualisht jemi në pritje të përgjigjeve te IMT dhe IKMT | Janë dërguar për një sërë çështjesh shkresat dhe akoma nuk kanë ardhur përgjigjet. | Janë dërguar për një sërë çështjesh shkresat dhe akoma nuk kanë ardhur përgjigjet. | Në proces |
| ZP Dibër | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Shkodër | | | | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | janë dërguar | janë pushuar çështjet pas konfirmimit pa problematika | janë arshivuar dosjet | realizuar |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie | | | I realizuar |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë kërkesat palës kreditore ja ka dërguar si kur doli ligji dhe gjithashtu kur doli VKM. | Kreditori nuk na jep një përgjigje për ti dhënë një zgjidhje ligjore konform nenit 616 K.Pr.Civile | Do të vijoj si me kërkesa individuale për çdo subjekt përfitues si dhe kërkesë të përsëritur me listën e subjekteve përfitues. | Në proces |
| ZP Pogradec | nuk kemi evidentuar dosje të mbartura që përfitojnë sipas ligjit | nuk kemi pasur probleme | | Realizuar |
| ZP Përmet | | | | Realizuar |

**Masa: 1.8.3 Në rast se pala kreditore (shteti kreditor) nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimi dytë shkresor, bërë nga përmbaruesi gjyqësor, të vlerësoshet pezullimi i dosjes përmbarimore në bazë të nenit 615/dh të Kodit të Procedurës Civile.**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| ZP Durrës | Zyra përmbarimore Durrës në rastet kur kreditore nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimin i dytë shkresor do të vijoj konform nenit 615/dh të K.Pr.Civile. | | | Në proces |
| Zyra Përmbarimore Lezhë | është përsëritur shkresa e dytë brenda afatit | IMT-Bashkia Lezhë nuk ka kthyer përgjigje akoma | IMT-Bashkia Lezhë nuk ka kthyer përgjigje akoma | në proces |
| Zyra Përmbarimore Pukë | nuk kemi një situatë të tillë | | | |
| ZP Elbasan | ZP Elbasan nuk ka dosje debitorëve të cilët përfitojnë nga ligji 127/2024 | | ZP Elbasan nuk ka dosje debitorëve të cilët përfitojnë nga ligji 127/2024 | |
| ZP Lushnjë | Janë njoftuar kreditorët për sjelljen e kërkesave për pushim për dosjet të cilat përfitojnë nga ligji 127/2024 | Pasi kemi komunikuar me IMTV, Bashkia Lushnjë e cila ka në ekzekutim edhe 10 dosje na kanë kërkuar kohë të evidentoj nëse përfitojnë apo jo pasi janë në ngarkesë për shkak të aksionit të lirimit të hapësirave publike | Do të përsëritet njoftimi sipas nenit 615/dh dhe do të vijohet me pezullimin e dosjeve sipas nenit 615/dh | në proces |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Zyra Përmbarimore Vlorë | Në proces | | | Në proces |
| ZP Korçë | Pala kreditore Drejtoria Vendore e Policisë Korçë është përgjigjur kërkesës tonë, ku me shkresën nr.5386/1,datë 31.07.2025 ka kërkuar pushimin e ekzekutimit në bazë të nenit 616/b të K.Pr.Civile. | | | I realizuar |
| ZP Fier | Nuk ka progres pasi nuk kemi përgjigje nga institucionet | | Mbetemi në pritje kthim përgjigjes | Në proces |
| ZP Sarandë | | | | |
| ZP Gjirokastër | | | | në proces |
| ZP Tropojë | Në proces | Nuk kemi pasur Problematika . | | Në proces |
| ZP Tiranë | | | | Në proces |
| ZP Dibër | | | Do të procedohet sipas nenit 615/dh pas njoftimit të dytë brenda 3 muajve nga përmbaruesi gjyqësor. | |
| ZP Shkodër | Janë evidentuar dosjet përmbarimore | në pritje të afatit 3 mujor | me përmbushjen e afatit do dilet me vendim | në proces |
| Zyra Përmbarimore Kurbin | nuk kemi një situatë të tillë | | | |
| ZP Mat | nuk ka dosje të kësaj kategorie në ekzekutim | | | |
| ZP Krujë | Zyra Përmbarimore Krujë në rastet kur pala kreditore nuk përgjigjet brenda tre muajve nga njoftimin i dytë shkresor do të vijoj konform nenit 615/dh të K.Pr.Civile. | | | Në proces |
| ZP Pogradec | Nuk kemi pasur raste kur pala kreditore mos të jetë përgjigjur brenda afatit ligjor | nuk kemi pasur probleme | | |
| ZP Përmet | | | | |

| Masa Nr.1.9<br>**Monitorimi dhe raportimi periodik i zbatimit të Planit të Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura.** | | |
|---|---|---|
| **Përshkrimi i problemit:** | Në zbatim të nenit 8 të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, ku ndër të tjera parashikohet se Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit kontrollon veprimtarinë e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, nevojitet monitorim dhe raportim të vazhdueshëm mbi zbatimin e masave në këtë plan pune, me qëllim garantimin e efektivitetit, përgjegjshmërinë dhe transparencën institucionale. | |
| **Masa: 1.9.1 Përcjellja e raportimit 6 mujor mbi realizimin e masave të parashikuara në këtë plan pune, nga 22 zyrat vendore përmbarimore.** | | |
| **Masa: 1.9.2 Hartimi i raportit 6 mujor dhe vjetor të Planit të Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura dhe dhënien e zgjidhjes ligjore nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.** | | |
| **Kompetenca:** | **Institucion përgjegjës** | **Institucion kontribues** |
| | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore<br><br>Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit | |
| **Burimet:** | Kryetarët<br>Përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë | |
| **Koha:** | Kohëzgjatja: 2025-2030 | Faza : |

**Masa 1.9 Monitorimi dhe raportimi periodik i zbatimit të planit të punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura.**

**Progresi**

Përcjellja e raportimeve mujore nga pjesa më e madhe e zyrave vendore drejt Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit është realizuar sipas planit. Nuk kanë raportuar asnjëherë Zyra Përmbarimore Berat dhe Kavajë. Raportimi ka mundësuar evidentimin e situatës së dosjeve të mbartura dhe identifikimin e nevojave për marrjen e masave në vijim për zyrat përmbarimore që nuk raportojnë.

**Problematika**

- Ngarkesë pune, duke shkaktuar vonesa në raportim.

**Hapat në vijim**

- Përfundimi i raportimeve mujore për të gjitha zyrat vendore sipas planit të punës.

- Ndjekja e realizimit të masave për uljen e numrit të dosjeve, duke raportuar progresin dhe arsyet e mosrealizimit aty ku ka pengesa.
- Rritja e koordinimit mes përmbaruesve individualë dhe kryetarëve të zyrave për të garantuar raportim të plotë dhe në kohë.
- Të kryhet njoftimi dhe dorëzimi i raportit përfundimtar nga Zyrat Përmbarimore Kavajë dhe Berat.

**Statusi**

Raportimet mujore janë pjesërisht të realizuara. Procesi është në vijim dhe kërkon koordinim të vazhdueshëm.

Gjatë vitit 2025, zyrat përmbarimore vendore kanë vijuar me zbatimin e masave për evidentimin, vlerësimin dhe trajtimin e dosjeve përmbarimore të mbartura, duke përfshirë detyrimet në të hollë, lirim/dorëzim sendi, shpenzime gjyqësore dhe gjoba administrative. Shumica e veprimeve janë kryer sipas procedurave ligjore, duke përfshirë përsëritjen e sekuestrove, bashkëpunimin me palët debitore dhe kreditore, si dhe institucione të tjera për mbështetje. Megjithatë, sfida mbeten në rastet me mungesë të adresës së debitorëve, bashkëpunim të kufizuar të palëve kreditore dhe vonesa raportimi nga disa zyra. Në përgjithësi, progresi është i dukshëm dhe pasqyron përkushtimin për përmirësimin e efikasitetit dhe uljen e numrit të dosjeve mbartura.